

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7664 E premte 28 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Në gjithë këtë histori, që ka mbërthyer publikun në thënie e kundërtënie, lajmi i fundit për koment është kallëzimi i Ballës për Bashën...

Vijon në faqen 20

Nga RUDINA XHUNGA

Po me Xhiselën, çfarë do bëhet?



Opinion **Ditës**

Nuk dihet ende nëse Taulant Balla zuri ndonjë peshk gjatë gjetjes në liqenin e Ohrit, por çka rezultoi tashmë e provuar botërisht është fakti se ...

Vijon në faqen 21

Nga ARMAND SHKULLAKU

Rasti Xhisela dhe organizata e strukturuar e Rilindjes



Kryetari i PD: Nuk jam 'Che Guevara'

Basha: Ramën nuk e rrëzoj unë me dhunë, por populli e bën për 7 ditë

Rikthehen "Të Paeksponuarit" në "News 24".
Përballja e kreut të opozitës me analistët

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, shpjegoi mbrëmë platformën e opozitës për vetëingun në politikë, duke u ndalur tek aspektet kryesore. Në emisionin "Të paeksponuarit" me Ylli Rakipin në "News24", përballë analistëve Fatos Lubonja dhe Andi Bushati, kryedemokrati Basha tha se me këtë proces synohet t'i jepet fund lidhjes së politikës ...

Në faqen 5

DESHMIA/ RREFIMI I VAJZES, XHISELA MALOKU: ME GODITI ME ARME NE KOKE

"DJALI I DEPUTETIT ME DOGJI ME CIGARE, ME RA TE FIKET"

Intervista e oficerit Emiljano Nuhu për kërcënimin nga Xhelal Rraja, prokuroria nis hetimet. Gazetari Basir Çollaku: Na kërcënuan me vrasje



(Në foto) Xhisela Maloku. Procesverballi i dëshmisë së Xhisela Malokut në policinë e Kruges



DHUNIMI I VAJZES

Taulant Balla kallzon Bashën. Artur Bushi: Nuk e njoh policin Nuhu

Në faqen 4

DURRES

83-vjeçarja gjendet e vvarë me thikë në kokë, prangoset nipi

Në faqen 7

KERKESE KOMPANIVE

Biletat e autobusit, Veliaj: Falas për fëmijët deri në 6 vjeç

Në faqen 11

SPEKTAKEL

Sezoni i ri në TV, kush janë prezantueset që ngejnë "pa ekran"

Suplement

UDHEZIMI I PLOTE



Ambasada e SHBA: Më 3 tetor hapet Lotaria Amerikane, ja si të aplikoni

Në faqen 17

EMRAT/ Ndërtimet pa leje, ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë

Legalizimet, 1500 personat që marrin lejen

Ndërtimet pa leje, procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga Agjencia

NGA ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 1500 personat kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Tiranës. Pronarët që kanë gati lejet janë në 11 njësitë e kryeqytetit dhe në zonat përreth. Përfituesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe



më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë ...

Në faqen 8-10

DOSJA "RRAJA" DESHMIA

"Shefi i madh i policisë më tha "ai që të do, të rreh"

Rrëfimi i Malokut: Janë fis kriminelësh, djali i deputetit më dogji me cigare

25-vjeçarja denoncoi dhunën në disa komisariate

Xhisiela Maloku, vajza e cila dyshohet të jetë përdhunuar nga djali i deputetit Rrahman Rraja, ka rrëfyer për dhunën që Rrexhep Rraja ka ushtruar ndaj saj rreth 2 muaj më parë. Në dëshminë e dhënë në komisaratin e policisë në Krujë para oficerit Emiljano Nuhu, më datë 30/07/2018, Maloku ka treguar arsyet pse ajo e ka tërhequr herën e parë kallëzimin ndaj Rexhepit. Sipas dëshmisë së saj Xhisiela tregon se është njohur me djalin e deputetit në vitin 2012, dhe ka qenë e lidhur me të deri në vitin 2017. 25-vjeçarja rrëfen se pas ndarjes me djalin e deputetit të PS, kanë filluar konfliktet. Ajo tregon se kallëzimin në polici e ka bërë për ngjarjen e ndodhur më datë 19.07.2018, ku sipas saj është takuar me Rexhep Rrajën, dhe pas një debati me tone të ashpër në makinë e tij, nën kërcënimin e armës ai e ka dërguar në një hotel. Në dhomë ajo tregon se është dhunuar nga djali i ish-deputetit të PS, është djegur me cigare në këmbë prej tij dhe është goditur në kokë më qytën e pistoletës. Si pasojë e dhunës së ushtruar vajza thotë se ka humbur ndjenjat dhe nuk kujton më gjë.



Xhisiela Maloku

Kur të ka goditur për herë të partë shtetasi Rexhep Rraja dhe në ç'vend?

Unë nuk e mbaj mend kur më ka goditur për herë të parë shtetasi i lartpërmendur, por mbaj mend herën e fundit që ndodhi në datën 19.07.2018. Dua të shpjegoj që në këtë datë më kishin të parë në rrugë dhe më mori në telefon, më tha hajde me tako se dua të sqarohemi, unë shkova e takova tek puna e tij në rrugën Fushë Krujë-Vorë, filloi të ulëritë me fjalë dhe më kapi prej flokësh, më solli një shoqe sms që a do dalim sot në ato moment ky më mori telefonin dhe ma theu, duke më thënë me kë do dalësh sot. Dua të them që, këto veprime i bëri kur unë isha në

makinë me të përball punës së tij, më pas u nis me makinë drejt hotel 'Boci', unë nuk pranova të shkoj lart në hotel me të, por me mori duke më bërë presion me anën e pistoletës.

Pistoletën ta drejtoi gjatë kohës që ishit në makinë, apo në ambient tjetër?

Pistoletën ma drejtoi gjatë kohës që isha në makinë me të, më pas zbritëm dhe shkua në hotel.

Sa kohë ndenjët në hotel dhe a kryet marrëdhënies kishit?

Unë ndenja me të në hotel rreth një orë, gjatë kohës që ndenjëm në hotel më gjuajti me shpulla, me grushte dhe më drejtoi pistoletën. Më dogji me cigare në kofshë dhe më goditi në pjesën e kokës me pistoletë. Mua më ra të fikët dhe u përmenda më vonë nuk më kujtohet a bëmë marrëdhënies seksuale, kur u përmenda po më merrte me të mira dhe më pas unë dola më para nga hoteli. Ai shkoi të paguajë lekët tek receptioni dhe me erdhi poshtë tek makina, ku unë po e prisja. Erdhi duke më përfaqura dhe duke më bërë lajka që unë mos të vija në polici për

kallëzim. Shqetësimet e mijë në lidhje me Rexhepin unë ia kam shprehur shoqëve të mia.

Këto përndjekje a i ke kallëzuar?

Nuk më kujtohet data e saktë, por mbaj mend që para vitit të ri kam shkuar në komisaratin nr. 6 në Tiranë dhe kam bërë kallëzim, unë sapa po jepja kallëzimin e tërhoqa dhe firmosa një deklaratë që u sqaruam për problemet tona.

Cila ishte arsyeja që nuk dhatë kallëzim në komisaratin nr. 6?

DENONCIMI

"Unë e tërhoqa kallëzimin, sepse shtetasi Rexhep Rraja më kërcënoi se do më vriste. Ata janë fis kriminelësh, rrinë gjithmonë me pistoletë unë nuk e kam babain", - dëshmoi Xhisiela Maloku.

Unë e tërhoqa kallëzimin, sepse shtetasi Rexhep Rraja më kërcënoi se do më vriste. Ata janë fis kriminelësh, rrinë gjithmonë me pistoletë, unë nuk e kam babain më është vrarë në 1997, jetoj me mamin dhe motrën. Nga fillimi i vitit 2018 unë kam

DHUNA
"Unë ndenja me të në hotel rreth një orë, gjatë kohës që ndenjëm në hotel më gjuajti me shpulla, me grushte dhe më drejtoi pistoletën. Më dogji me cigare në kofshë dhe më goditi në pjesën e kokës me pistoletë. Mua më ra të fikët dhe u përmenda më vonë nuk më kujtohet a bëmë marrëdhënies seksuale, kur u përmenda po më merrte me të mira dhe më pas unë dola më para nga hoteli", -tregon 25-vjeçarja.

shkuar në komisaratin e Krujës për të bërë kallëzim, po nuk kam bërë kallëzim vetëm kam firmosur një deklaratë tek inspektori i zonës, këtë deklaratë e ka firmosur dhe motra ime. Tek deklaratat kemi shkruar që nuk kemi problem dhe i kemi sqaruar konfliktet. Aty më doli një person dhe m'u prezantua si shefi i madh dhe më tha që ai që të do të rrahë. Atë ditë më kishin të rrahur shumë Rexhepi, mbaj mend që isha bërë me gjak. Dua të shpjegoj që kallëzimi i radhës është ai i



KERCENIMI

Kërcënimi më ka ardhur rreth orës 03:00 të datës 22.07.2018, nga një emër që se lexova dot, sepse më bëri bllok dhe në mesazhin që më erdhi në 'Instagram' ishte me tekstin "që unë kam shkuar me pushime dhe sa të kthehem do të vras".

icisë Krujë, por shkove tek komisarati i policisë nr. 3 në Tiranë?

Unë nuk erdha tek komisarati i policisë në Krujë se kam ardhur më parë dhe nuk më ka marrë njeri kallëzimin, dhe te komisarati nr. 3 në Tiranë shkova njëherë më datë 20.07.2018, një ditë pasi ndodhi ngjarja por nuk ma mori njeri kallëzimin, se aty erdhi shumë shpejt shtetasi Rexhep Rraja, R.Rr, XH.Rr dhe babai i Rexhepit, i cili është deputeti Rrahman Rraja, ky i fundit e rregulloi me policat që unë të mos jepja kallëzim.

A disponon foto në lidhje me dhunën e ushtruar dhe keni shkuar për të marrë ndihmë mjekësore?

Unë nuk disponoj foto në lidhje me dhunën e ushtruar nga shtetasi Rexhep Rraja, sepse nuk kam bërë foto dhe nuk kam shkuar në asnjë institucion për të marrë ndihmë mjekësore, dëmtimet e fundit janë ato që ju mi keni fotografuar tek zyra e prokurorës Mirela Kapo. Këto dëmtime që ju më fotografuat nuk janë asnjë gjë, herët e tjera më ka rrahur me shumë dhe më ka çuar në hotel, më mua ka bërë seks kundër dëshirës sime, por nuk kisha ku ta kallëzoja.

A jeni kërcënuar nga ndonjë shtetas në 'Instagram' dhe cili ka qenë ky person?

Kërcënimi më ka ardhur rreth orës 03:00 të datës

22.07.2018, nga një emër që se lexova dot, sepse më bëri bllok dhe në mesazhin që më erdhi në 'Instagram' ishte me tekstin "që unë kam shkuar me pushime dhe sa të kthehem do të vras". Nga kërcënimi që më bëri në 'Instagram' shkova në drejtorinë vendore të policisë Durrës dhe më konkretisht tek zyra e SHKB, ku shpreha pakënaqësitë e konstatauar nga policia e Fushë-Krujës dhe kallëzova tek zyra e SHKB, presionin dhe kërcënimin që më është bërë në zyrën e oficerit nga shtetasi Ramazan Rraja, Xhelal Rraja, Redjan Rraja, Rexhep Rraja dhe nga deputeti Rrahman Rraja. Nuk guxoj të dilja nga zyra e oficerit Gentjan Citozi se ishin disa persona të tjerë dhe ma bënin me shenjë që do të vrasim n.q.s. nuk tërheq kallëzimin. Aty më morën dhe një avokat dhe një psikolog kundër dëshirës sime dhe më thoshin do firmosësh deklarinë që do të përpiqej oficeri Gentjan Citozi se është miku jonë. Unë ndenja rreth dy orë duke mos e firmosur deklarinë, por ishte e pamundur se po më kërcënonin me pistoletë, më nxirrin jashtë zyre dhe thoshin oficerit na e lër ne se e rregullojmë dhe më çonin te makina duke më goditur me grushte në bark dhe më vendosnin pistoletën në kokë, pastaj nuk pata zgjidhje tjetër dhe firmosa deklarinë.



Rexhep Rrahja

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka çelur një hetim për të sqaruar pretendimet e ngritura nga ish-oficeri i policisë Emiljano Nuhu se ishte kërcënuar me armë në postën e policisë Fushë-Krujë, në praninë të deputetit të PS-së Traian Balla dhe kryebashkiakut të Krujës, Artur Bushi, pasi kishte marrë denoncimin e një vajze kundër djalit të deputetit Rraman Rraja. Mësohet se po verifikohen gjithë procedurat e ndjekura nga policia në lidhje me denoncimet e bëra për përndjekje nga 25-vjeçarja Xhisiela Maloku, po ashtu edhe denoncimet për kërcënime nga ish-oficeri i policisë, SHÇBA ka zbardhuar në Komisaritet nr. 3 dhe 6 në Tiranë, si dhe stacionin e Fushë Krujës, duke sekuestruar librat e shërbimit.

Gjithashtu, prokuroria e Tiranës ka nisur një hetim në lidhje me dëshminë e publikuar të mërkurën të Emiliano Nuhut. Organi i akuzës po heton mbi kallëzimin e bërë nga ana e ish-oficerit Nuhu për "kanosje për shkak të detyrës". Në kallëzimin e bërë në 1 shtator, Nuhu pretendon se është kërcënuar nga dy të afërmit të deputetit në një lokal në Tiranë. Takimi në fjalë është zhvilluar në një lokal në zonën e Unazës së Re në kryeqytet. Prokuroria ka sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë së lokalit, të cilat nuk kanë audio. Nga këqyrja e pamjeve rezultoi se tre personat janë takuar, kanë biseduar dhe janë përsëritur me shtrëngim duarsh. Në deklaratim e dhëna për illogaritë të hetimit dy familjarët e Rrahjës kanë pohuar se janë takuar vetëm për të diskutuar dhe kanë mohuar çdo kërcënim ndaj oficerit Nuhu. I njëjti fakt konstatohet edhe nga gjuha e trupit e tre personave në këtë takim. Hetimi ka zbuluar se takimi është lënë në një komunikim në whatsapp mes tyre dhe oficerit. Në analizë të komunikimit, të sekuestruar nga telefoni i njërit prej tyre, rezultoi se i kanë kërkuar të takohen për të folur dhe se nuk ka ndonjë frazë kërcënuese.

DENONCIMET
Pasditen e së shtunës të datës 21 korrik 2018 në komisaritet nr. 3 është para-

Denoncimet për përndjekje, në verifikim procedurat e ndjekura nga policia

Dëshmia e ish-oficerit Nuhu, prokuroria e Tiranës nis hetimet

SHÇBA sekuestron librat e shërbimit në disa komisariate



Komisariati i Policisë Nr. 3

SHÇBA

Mësohet se po verifikohen gjithë procedurat e ndjekura nga policia në lidhje me denoncimet e bëra për përndjekje nga 25-vjeçarja Xhisiela Maloku, po ashtu edhe denoncimet për kërcënime nga ish-oficeri i policisë, SHÇBA ka zbardhuar në komisaritet nr. 3 dhe 6 në Tiranë, si dhe stacionin e Fushë Krujës, duke sekuestruar librat e shërbimit.

Intervista me ish-policin, gazetari Basir Çollaku: Na kërcënuan me vrasje

Gazetari Basir Çollaku thotë se ka marrë kërcënime një ditë pasi publikoi intervistën me ish-oficerin Emiljano Nuhu. Përmes një statusi në 'Facebook', Çollaku shkruan se ka marrë kërcënime deri në vrasje, menjëherë sapo u publikua pjesa e parë e intervistës. "Sapo Televizioni 'Shijak' transmetoi pjesën e parë të intervistës së nënkomisaris Emiljano Nuhut, që denonconte kansen në zyrë ndaj tij të djalit të deputetit Rrahman Rrahja, në praninë të deputetit Taulant Balla dhe kryebashkiakut Artur Bushi, banda e trazuar nisi nga kërcënimet. Një telefonatë vjen në numrin fikst të redaksisë dhe thotë: "Do t'ju vrasim, do t'ju fshijmë"- shkruan Çollaku ndërsa apelon prokurorinë të humtojë e të gjëjë telefonuesin e bandës kriminale. "Prokuroria nëse është vullnetdashëse në zbatim të ligjit mund të humtojë dhe gjëjë telefonuesin e bandës kriminale. Ne do të vazhdojmë të përbushim misionin tonë të fjalës së lirë." - përfundon Çollaku.

Kërkesa



BASIR ÇOLLAKU

"Prokuroria nëse është vullnetdashëse në zbatim të ligjit mund të humtojë dhe gjëjë telefonuesin e bandës kriminale. Ne do të vazhdojmë të përbushim misionin tonë të fjalës së lirë", - shkruan gazetari Basir Çollaku.

qitur 25-vjeçarja Xhisiela Maloku, e cila ka denoncuar për përndjekje ish-të dashurin e saj Rexhep Rraja. Sipas asaj që 25-vjeçarja ka thënë para uniformave blu konfliktet mes të rinjve kanë nisur në fund të vitit 2017, atëherë kur edhe lidhja e tyre ka marrë fund. Gjatë këtyre muajve mes Xhisiela Malokut dhe Rexhep Rrahjës ka pasur disa epizode dhune për të cilat 25-vjeçarja ka shkruar në disa komisariate si në komisaritetin nr. 3, komisaritetin nr. 6 në komisaritetin e Krujës si edhe në stacionin e policisë në Fushë-Krujë. Por për arsye ende të paqarta vajza nuk i shkonte deri në fund denoncimit dhe linte deklaratat me shkrim se problemet mes saj dhe ish-të

dashurit janë shuar. Në intervistën e dhënë për gazetarin Basir Çollaku, ish-oficeri i policisë Emiljano Nuhu thotë se 25-vjeçarja nuk arrinte të kryente kallëzimin

pasi kërcënohej me jetë nga ish-i dashuri dhe të afërmit e tij. Edhe guximi i marrë më 21 korrik ku në orën 19:00 vajza u paraqit në këtë komisaritet zgjati pak, pasi 2 orë më vonë, në orën 21:00 ajo u paraqit në stacionin e policisë në Fushë-Krujë ku kërkoi të tërheqte denoncimin për përndjekje. Prej datës 21 korrik dhe deri në datën 30 korrik vajza u paraqit disa herë në komisaritet e policisë. Pas marrjes së denoncimit tek komisariteti nr. 3 çështja u delegua në Fushë-Krujë aty ku edhe jetonte vajza dhe i akuzuari. Me rastin e vajzës u mor oficeri Gentjan Çitozi, i cili u denoncua nga vajza në SHÇBA e Durrësit pasi ai nuk po merrej siç duhej me rastin.

Më pas çështja iu kalua Emiljano Nuhut, i cili më 30 korrik ka marrë në pyetje vajzën dhe ka tentuar të marrë në pyetje Rexhep Rrajan. Në këtë moment ish-oficeri Nuhu pretendon se është kërcënuar me jetë në zyrën e tij nga xhaxhai i Rexhepit, Xhelal Rraja, i cili i vuri pistoletën në kokë. Të pranishëm në zyrë sipas Nuhut ishin deputeti Rraman Rraja, i shoqëruar nga kryetari i bashkisë së Krujës Artur Bushi dhe deputeti Taulant Balla. Po të njëjtën ditë, Nuhu pretendon se teksa po kthehej në banesën e tij në Tiranë është kërcënuar nga pjesëtarë të fisit Rraja, të cilët i kanë lënë takim në një lokal në zonën e Unazës së Re.

PRETENDIMI

Kërcënimi ndaj ish-oficerit të policisë Emiljano Nuhu

Cështja iu kalua Emiljano Nuhut, i cili më 30 korrik ka marrë në pyetje vajzën dhe ka tentuar të marrë në pyetje Rexhep Rrajan. Në këtë moment ish-oficeri Nuhu pretendon se është kërcënuar me jetë në zyrën e tij nga xhaxhai i Rexhepit, Xhelal Rraja, i cili i vuri pistoletën në kokë. Të pranishëm në zyrë sipas Nuhut ishin deputeti Rrahman Rraja, i shoqëruar nga kryetari i bashkisë së Krujës Artur Bushi dhe deputeti Taulant Balla.



Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material komëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhoma Komëtare e Neterisë (DH.K.N.) from Operatorit Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.
Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pagesës prej **10.000 leke**, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri.
Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**



SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- "Pyl" + Kullote" me sip. 280.000 m2, Nr. hipotekar 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillo ankadit është 3.024.207 Euro. Ankandit zhvillohet date 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr: "Çemalli", Pall: "Fratar", K:6.Tirane.
2- "Pyl" + Kullote" me sip. 45.000 m2, Nr. hipotekar 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillo ankadit është 1.026.060 Euro. Ankandit zhvillohet date 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr: "Çemalli", Pall: "Fratar", K:6.Tirane.
3- "Fratar" + Ndërtim" me sip.3.250 m2 nga Kjo 14745 m2 ndërtim me adresë: Xhatullaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillo ankadit është 490.699 Euro. Ankandit zhvillohet date 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr: "Çemalli", Pall: "Fratar", K:6.Tirane.
4-Për pasuritë me Nr 10074-15, vol.41, nr.89, ZK 8513, me sip.1192 me adrese Rr: "Muzo"15, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillo ankadit është 36.036 Euro. Ankandit zhvillohet date 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr: "Çemalli", Pall: "Fratar", K:6.Tirane
Për çdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al



SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fah Dalia", Kompleksi Koka 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
Web: www.3h.al; Email: sh3@yahoo.com cel:0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.25.09.2018 deri ne dt. 05.10.2018 per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M
Cmimi fillestar është 1419 EURO

Ankandit zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 05.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

SKANDALI REAGIMET

PD: Heshtja e Ramës për denoncimin e nënkomisarit, pjesë e skenarit mafioz

Valentina Madani

Taulant Balla kallëzoi dje penalisht në Prokurorinë e Tiranës kryetarin e opozitës, Lulzim Basha; ish- nënkomisarin e policisë së Krujës, Emiliano Nuhun si dhe gazetarin Basir Çollaku, për lidhjen e emrit të tij me një ngjarje të zhvilluar në 21 korrik në Komisaratin e Krujës. Balla pretendon se kreu i opozitës ka shpërdoruar detyrën, ka bërë kallëzim të rremë në adresë të tij, si dhe e ka fyer qëllimisht. Për të njëjtat vepra, kreu i grupit parlamentar socialist, Balla akuzon dhe ish-oficerin e policisë dhe gazetarin Çollaku. "I bëj thirrje prokurorës së përgjithshme, Prokurorisë së Tiranës, Policisë së Shtetit të marrin të gjitha përgjegjësitë që u takojnë në zbardhjen e këtij inskenimi të turpshëm. E garantoj Lulzim Bashën, gjobaxhiun e rëndomtë të sipërmarrësve, mos guxo të më vendosësh edhe mua gjobe me kusht mospërbaljen. Je shumë i dobët për mua, Lulzim. Mirë kryetar partie se nuk di ta bësh, duke e degraduar PD në një organizatë banale babalesh. Mos guxo të bësh me as regjisorin apo skenaristin, sepse qenke për turp", deklaroi z.Balla. Por, ai paralajmëroi se sot do të padisë edhe Edi Palokën për shpifje.

AKUZA
Edi Paloka, nënkryetari i PD-së foli dje për një skenar përmes së cilit po tentohet mbyllja e skandalit "Balla", që sipas opozitës ekspozon lidhjet e bashkëpunëtorëve të kryeministrit me krimin. Sipas opozitës, dëshmia tronditëse e oficerit të policisë, Emiljano Nuhu është pasqyra e vërtetë e kriminalizimit të thellë të qeverisjes nën drejtimin e Edi Ramës. "Heshtja e kryeministrit të vendit pasi një vajzë është torturuar nga djali i deputetit të vet, heshtja e kryeministrit për aktet kriminale të deputetit Rrahman Rraja, heshtja e kryeministrit për sjelljen prej banditi të kryetarit të grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, i përfshirë në kërcënimin me pistoletë në kokë të oficerit të policisë; heshtja e Edi Ramës, që ka shndërruar Policinë e Shtetit në organizatë kriminale flet më mirë se asgjë tjetër se ai dhe qeveria e tij është gjysma e bandës në pushtet, që mbron bandat dhe banditët që kontrollojnë sot territorin, shtetin dhe policinë", deklaroi z.Paloka. Ai iu përgjigj deklaratave të Ballës për kallëzimin për shpifje ndaj tij, duke thënë se ai po mbron përdhunuesin e një jetimeje, ndërsa më parë

Skandali, Balla kallëzon Bashën. Paloka: Po prishin provat

Bushi: Shpifje, nuk e njoh oficerin Nuhu



TAULANT BALLA
"Nuhu është një fatkeq që po e shpërdoron Basha. Unë nën cilësinë e kryetarit të Grupit sapo është publikuar rasti në media tre muaj më parë, e kam thirrur deputetin Rrahja të më shpjegojë ngjarjen. Z. Rraja më ka informuar se lidhur me këtë rast ka qenë një konflikt mes dy të rinjve që kanë pasur një marrëdhënie intime. Ai më konfirmoi se ka gjetur një zgjidhje mes tyre" - tha Balla.

EDI PALOKA
"Rama po zbaton të njëjtin skenar mafioz për të mbyllur skandalet që ekspozojnë lidhjet e tij dhe bashkëpunëtorëve të tij me të ngushtë me krimin. Sa herë ata kapen në flagrancë në bashkëpunim me krimin, Rama vërsul taulantët e tij të lidhur me krimin e organizuar për të sulmuar denoncuesin e krimin, për të prishur provat", - tha Paloka.

Vajza e dhunuar të merret në mbrojtje

Çështja "Rraja", Kryemadhi: Prokuroria të hetojë njerëzit e implikuar

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, i kërkoi dje prokurorisë të mos heshtë, por të hetojë ngjarjen e fundit që ka të bëjë me dhunimin e një vajze nga djali i një deputeti. Kryemadhi i kërkoi prokurorisë e policisë të marrin në mbrojtje Xhisiela Malokun, vajzën që denoncoi Rexhep Rrajan. Por reagim Kryemadhi ka kërkuar edhe nga shoqëria civile dhe organizatat që mbrojnë gratë. "Do të ishte e rëndë që ngjarja të mos hetohet, i bëj thirrje prokurorisë dhe segmenteve të shtetit që ndihen të painkrimiuara, për të gjithë situatën që është përfshirë sot, të marrin në mbrojtje Xhisiela Malokun. Prokuroria duhet të hetonte se kush ishin ata persona që e çuan në atë TV. Nuk më shqetëson apo më bën çudi pjesëmarrja e Taulant Ballës në këtë ngjarje, sepse më parë se të sqarojë pozicionin e tij në këtë histori, duhet të thotë nëse qëndron se djali i deputetit të PS jo vetëm që ka kryer këtë krim, por është i kërkuar nga drejtësia. Drejtësi që është e kapur edhe nga djali i deputetit të PS", deklaroi Kryemadhi. Ajo u bëri më tej apel shoqatave të denoncojnë dhunuesin e vajzës.



ka qenë edhe vetë i akuzuar për përdhunim. Paloka tha se në gjyq do t'i japë të gjitha me detaje nga burime origjinale, duke i treguar deputetit socialist se ka ca të njohur në Laç.
REAGIMI
Kryetari i Bashkisë së Krujës, Artur Bushi, mohoi


dje të ketë qenë në Komisaratin e Fushë-Krujës dhe përfshirjen e tij në skandalin e dhunimit të një të reje, ku akuzohet djali i një deputeti socialist. Ai i quan shpifje, deklaratat se ka qenë në zyrën e oficerit të policisë kur atij i është vënë pistoletë në kokë dhe këtë sipas tij

PD, Çupi: Vajza u dhunua, të ngrihemi në revoltë

Kryetarja e Aleancës së Grave Deputete, Dhurata Çupi shprehet se djegia e trupit me cigare dhe përdhunimi i vajzës së re nga Fushë-Kruja është një ngjarje që duhet të na ngrejë në revoltë. Zj.Çupi kërkoi nga institucionet përgjegjëse të veprojnë në zbatim të ligjit dhe jo të ndikimit nga individë në pushtet. "Djegia e trupit me cigare dhe përdhunimi i vajzës së re nga Fushë-Kruja është një ngjarje që duhet të na ngrejë në revoltë. Nuk është vetëm veprimi skandaloz që është kryer nga djali i një ligjvënës shqiptar, por edhe sjellja dhe mbrojtja që i ka vënë në dispozicion dhunuesit të saj. Ky është skandal përtej skandalit që thellon frikën, duke mbyllur gojën përpara një pushteti që s'di të ndalet në anën çnjerëzore të tij edhe për ngjarje të tilla", tha zj.Çupi.

e vërtetojnë kamerat në komisarariat. "Nuk e njoh oficerin në fjalë. Nuk i di emrin dhe nuk e kam takuar kurrë. Njëkohësisht, as që bëhet fjalë që të kem qenë në ambientet e rajonit të policisë së Fushë-Krujës, as vetëm e as bashkë me ato që oficeri apo ish-oficeri tani pretendon.

ORIOLA PAMPURI
Deputetja e PD-së, Oriola Pampuri sulmoi dje deputetët e PS, Elisa Siproalpin dhe Ervin Bushatin. Sipas saj, deputetja Spiropali shfrytëzoi postin në doganë për t'u bërë pjesë e politikës, ndërsa shtoi se Ervin Bushati i shiti pronën Linda Ramës, aty ku kryeministri ndërtoi vilën në Surrel.
Garantoj se kjo shpifje do të hidhet poshtë me fakte, pasi rajoni policor ka kamera dhe nëse unë do të kisha qenë, do të isha filmuar. Është në ngarkim të organeve kompetente të verifikojnë kamerat të të provojnë se e gjithë kjo është një shpifje e madhe", shprehet z.Bushi.



Berisha: Dosja e Xhisielës iu dha Çitozit, mik i Bushit

Ish-kryeministri Berisha deklaroi dje se kreu i Bashkisë së Krujës Artur Bushi dhe oficeri Gentian Çitozi të përfshirë në skandalin e dhunimit e përdhunimit të një vajze nga Fushë-Kruja janë miq të ngushtë. Kjo është dhe arsyeja që sipas Berishës, dosja iu hoq Nuhut dhe iu dha Çitozit. Për më tepër sipas qytetarit që denoncon tek Berisha, gruaja e Çitozit është sekretare e Artur Bushit. "Ja pse dosja e Xhisielës iu hoq Nuhit dhe iu besua Çitozit! Qytetari dixhital denoncon: Gentian Çitozi mikun më i ngushtë i Artur Bushit! Bashkëshortja Çitozi sekretare e Artur Bushit! Z.Berisha kjo vajza Xhisiela Maloku është e kërcënuar dhe e shantazhuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Gentian Çitozi që është mikun më i ngushtë i Artur Bushit që qysh ditën e parë të punës si kryetar bashkie e ka marrë sekretare gruan e oficerit Gentian", thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë qëndrimit në Nju Jork, priti në një takim të veçantë Presidentin dhe themeluesin e Fondacionit Ndërkombëtar hebre "Raoul Wallenberg", zotin Baruch Tenenbaum, së bashku me anëtarë të tjerë të këtij Fondacioni. Presidenti Meta vlerësoi nismën e zotit Tenenbaum dhe të Fondacionit Ndërkombëtar "Raoul Wallenberg" për ta deklaruar Shqipërinë si "Shtëpinë e Jetës", në respekt të kontributit që populli shqiptar dhe Shqipëria kanë dhënë për mbrojtjen

Presidenti i Republikës pritet nga Mogherini, takim me fondacionin hebre

Meta: Asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve, kjo na bën krenarë

dhe strehimin e një numri të madh hebrejsh gjatë Holokaustit. Presidenti Meta mbështeti idenë e organizimit në Tiranë të një ceremonie të veçantë për këtë qëllim dhe vendosjen e një pllakate në nderim të kontributit të popullit shqiptar. Duke u ndalur në marrëdhëniet historike e tradicionale midis shqiptarëve

dhe hebrejve, Presidenti Meta, nënvizoi se: "ishte kjo miqësi, si dhe kodi shqiptar i besës, që bënë që gjatë Holokaustit, numri i hebrejve në Shqipëri të shumëfishohej dhe për këtë ne shqiptarët jemi krenarë". "Asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve dhe tragjedi të tilla të së kaluarës me hebrejtë, apo edhe ato etnike të

ndodhura në rajonin e Ballkanit, nuk duhet të përsëriten. Kurrë më!", - nënvizoi Presidenti Meta. Nga ana e tij, zoti Tenenbaum, e falënderoi Presidentin Meta për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, si dhe nënvizoi mirënjohjen e thellë të hebrejve për rolin që kanë luajtur shqiptarët gjatë Holokaustit. Meta ishte pjesë e



pritisë së shpeshe së politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, e cila mbodhi në Nju Jork me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor. Zëdhënësjja e saj, Maja Koçijanciq, përmes

një postimi në 'Twitter' tha se Mogherini ka zhvilluar një takim me liderët e Ballkanit Perëndimor, ku është biseduar për situatën në rajon, bashkëpunimin rajonal dhe punën për integrimin evropian.

Katër ministra të Jashtëm të BE-së do të vijnë në Tiranë: Mbështetje për negociatat

Darina Tanushi

Vendet e Bashkimit Evropian vijnë të mbështesin negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Këtë radhë në New York u takuan ministrat e jashtëm të Greqisë, Bullgarisë, Rumanisë e Kroacisë në cilësinë e katër vendeve ballkanike anëtare në Union. Në takim kryediplomatët ranë dakord të vizitojnë Shqipërinë për të ndihmuar në procesin e bisedimeve. Lajmin e bëri të ditur Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias. "Ne sapo përfundam mbledhjen e katër shteteve të Ballkanit që janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Ne ramë dakord për të forcuar bashkëpunimin tonë para së gjithash për të stabilizuar rajonin tonë. Ne planifikojmë deri në fund të vitit që të katër të vizitojnë Shqipërinë dhe Maqedoninë veriore për të parë se si mund t'i ndihmojmë ata në qasjen e tyre evropiane", tha Kotzias. Në New York në kuadër të punimeve të asamblesë së OKB pritet dhe një takim dypalësh mes Ministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati me homologun grek Nikos Kotzias. Ndërkohë Shqipëria dhe Maqedonia nënën dje, në Bruksel takimin e parë shpjegues të legjislacionit të BE-së për kapitullin e 23-të të negociatave të anëtarësimit "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore". Ky është i pari i një serie takimesh që do të zhvillohen me Komisionin Evropian për kapituj të ndryshëm të negociatave të anëtarësimit. Takimet e shpjegimit të legjislacionit të BE dhe të ekzaminimit të shkallës së përputhjes së legjislacionit të

Gjonaj në Bruksel, nis "sreening": Reforma në drejtësi e pakthyeshme


Takimi i 27-28 shtatorit shënon fillimin e punës teknike



drejtësi është një proces i pakthyeshmë tashmë dhe se ajo po jep rezultatet e para shumë të rëndësishme për pastrimin e sistemit gjyqësor nga gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar. Ky është i pari i një serie

takimesh që do të zhvillohen me Komisionin Evropian për kapituj të ndryshëm të negociatave të anëtarësimit. Takimet e shpjegimit të legjislacionit të BE dhe të ekzaminimit të shkallës së përputhjes së legjislacionit të

vendit kandidat normalisht zhvillohen pas hapjes zyrtare të negociatave. Gjatë takimit, delegacioni shqiptar do të njihet me aktet ligjore dhe politikak kryesore të Bashkimit Evropian që synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi drejtësi të pavarur dhe eficient. Në takim, gjithashtu, trajtohen lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore të njeriut e të drejtat e qytetarëve të Bashkimit Evropian, sikurse garantuar nga Karta e të Drejtave Themelore dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian, duke përfshirë këtu mbrojtjen e të dhënave personale, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e minoriteteve, përfshirjen e Romëve, etj.



Xhaçka në Austri: Shqipëria mbetet faktor sigurie në rajon

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka mori pjesë dje, në takimin Ministror të Mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Presidencës Austriake të Këshillit të Bashkimit Evropian. Takimi, i mbajtur në Graz (Austrië) ishte një nismë e ministrit të Mbrojtjes të Austrisë, Mario Kunasek, në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga pala austriake për prioritetet në fushën e mbrojtjes. Ministria Xhaçka, në fjalën e saj tha se platformat e tilla komunikimi përmirësojnë më tej dialogun e strukturuar midis Bashkimit Evropian dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor në nivel të sigurisë dhe mbrojtjes. "Trajtimi i sfidave të sigurisë mbetet një nga prioritetet tona kryesore, pasi është një interes i përbashkët për të pasur një kujdes të veçantë për rajonin tonë. Megjithëse kërcënimet e sigurisë po bëhen shumë të ndryshme në zonën euroatlantike, ne kemi bërë një përparim të shkëlqyer në drejtim të sigurisë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria vazhdon të luajë një rol konstruktiv duke prodhuar siguri për rajonin", -tha ministria Xhaçka në fjalën e saj. Duke u ndalur në referendumin që pritët të mbahet në Maqedoni ditën e diel, ministria e Mbrojtjes tha se: kemi besimin e plotë se ky referendum do jetë një hap i sigurtë në drejtim të paqes, sigurisë dhe prosperitetit jo vetëm për qytetarët maqedonas, por për të gjithë rajonin. Ministria Xhaçka i njohu homologët e Austrisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës me strukturat e rëndësishme të sigurisë dhe bashkëpunimit që vendi ynë pritët të drejtojë gjatë vitit të ardhshëm, si: Karta e Adriatikut, Procesi i Ministrit të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM), si dhe Verifikimi Rajonal i Kontrollit të Armëve dhe Qendra e Asistencës për Zbatimin (RACVIAC). Të gjitha këto, tha ministria Xhaçka janë tregues i pjekurisë dhe aftësisë së Shqipërisë për të drejtuar procese të rëndësishme në fushën e sigurisë. Ministrat e Mbrojtjes nënshkruan në fund të takimit deklaratën e përbashkët, për thellimin e bashkëpunimit mes vendeve për përballimin e sfidave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ambasadorja gjermane: Vetingu në politikë nuk duhet të ngatërrohet me atë në drejtësi

Ambasadorja gjermane Sussane Schutz përsëndeti nismën e ndërmarrë nga opozita për vetingun në politikë, por tha se ai nuk duhet të ngatërrohet me reformën në drejtësi. Ambasadorja gjermane tha për mediat se pastrimi i politikës dhe ecja para në reformën në drejtësi do të bëhet pas ngritjes së institucioneve të posaçme SPAK dhe Byrosë së Hetimit. "Politikanët duhet të shkojnë para drejtësisë dhe të ndiqen penalisht në rast se kanë kryer penale, por vetingu në politikë nuk duhet të ngatërrohet me atë të drejtësisë". "Për politikanët dhe për çdo kënd tjetër duhet të jetë i



njëjti parim. Vepra penale, korrupsioni janë të papranueshme dhe si të tilla duhet të ndiqen penalisht. Është mjaft e rëndësishme që për këtë qëllim të krijohen organet e duhura të sistemit të drejtësisë, të cilat do të mundësojnë ndjekjen penale, përfshirë këtu edhe

kur subjektet janë politikanë. Por kaq e rëndësishme është të mos ngatërrohet vetingu në sistemin në drejtësi me vetingun në sistemin e politikës", tha Schutz. E pyetur për reformën në drejtësi dhe mosngritjen ende të strukturës së posaçme Antikorrupsion SPAK dhe Byrosë së hetimit, ambasadorja gjermane ka këtë argument: "Më lejoni të them paraprakisht që procesi i vetingut, që është duke u zhvilluar në Shqipëri, është një shans real dhe mjaft i rëndësishëm për vendin që do vendosë të gjithë sistemin e drejtësisë mbi një bazë të re dhe të pavarur nga politika", -u shpreh ambasadorja gjermane.

Redi Shkurti, hetuesve: S'e kam goditur gjyshen. Zbardhet telefonata me shokun

83-vjeçarja gjendet e vvarë me thikë pas koke në banesë, prangoset nipi

Policia: I riu i skeduar si përdorues droge, tentoi të fshihte provat në vendngjarje

Klodiana Haxhijaj

DURRËS

Një 83-vjeçare nga Durrës është gjetur e vdekur në katin e tretë të pallatit ku banonte. Ka qenë nipi i viktimës që ka ndihmën e mjekëve të urgjencës së spitalit rajonal të qytetit bregdetar, duke u thënë: "Hajdeni shpejt se kam gjyshen shumë të sëmurë". Në fakt, Floresha Shkurti është gjetur e pajetë, e shtrirë në pllakat e kuzhinës. Pas hetimeve paraprake, policia deklaroi se e moshuara ka një plagë në kokë dhe se po hetohet në dy pista: Për vdekje aksidentale dhe për vrasje. Por disa orë pas ngjarjes së ndodhur pasditen e djeshme, në lagjen nr. 16 të qytetit të Durrësit (pranë shkollës 9-vjeçare "Qemal Mici"), burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se referuar ekspertizës mjeko-ligjore, rezultoi se 83-vjeçarja Shkurti është vvarë. Sipas bluve, viktima është goditur me mjet prerës pas koke (maje thike). Mësohet se në lidhje me këtë ngjarje të rëndë është ndaluar nipi 23-vjeçar i viktimës, Redi Shkurti, i cili është i dyshuari kryesor i vrasjes së gjyshes së tij. I riu është skeduar si përdorues i lëndëve narkotike.

VRASJA

Rreth orës 13:00 të ditës së djeshme, mjekët e spitalit të Durrësit kanë njoftuar policinë për vdekjen e 83-vjeçares Floresha Shkurti. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur policia, e cila ka kryer veprimet paraprake hetimore. Nga këqyrja e trupit të pajetë është vënë re një goditje në kokë. Po ashtu në banesë janë gjetur edhe gjurmë pranë viktimës, e cila jetonte me nipin. Ky i fundit është shoqëruar në polici, ku është marrë në pyetje. Ndërkaq, kufoma është nënshtruar ekspertizës, nga e cila ka rezultuar se e moshuara është vvarë me një mjet prerës që dyshohet të jetë thikë. I dyshuari, është nipi i viktimës, Redi Shkurti. Nga hetimet e kryera ka rezultuar, se 23-vjeçari fillimisht ka njoftuar urgjencën dhe pastaj i ka telefonuar nënës së tij, e cila punon në një resort turistik tek plepat. "Lerë punën sot dhe hajde në shtëpi se ka vdekur gjyshja", mësohet t'i ketë thënë ai së ëmës. Sipas hetuesve të çështjes, i riu i ka telefonuar dhe një shoku të tij, të cilit i ka kërkuar ndihmë, duke i thënë: "Eja më ndihmo se ka një hall të madh". Nuk bëhet me dije nëse shoku i 23-vjeçarit ka shkruar apo jo në shtëpinë e familjes Shkurti. Hetuesit e çështjes sqaruan se është tentuar që të lëvizet kufoma dhe të prishen provat në vendngjarje. Ndërsa, fqinjët e viktimës thanë se nipi i të moshuarës ishte i papunë dhe problematik. Ende nuk dihet motivi i vrasjes së 83-



Pallati ku ndodhi vrasja



Policia në vendin e ngjarjes

FQINJËT E VIKTIMËS

Pas gjetjes së trupit të trupit të 83-vjeçares Floresha Shkurti, fqinjët e viktimës thanë për "Gazeta Shqiptare" se e moshuara jetonte prej disa kohësh me nusen e djalit dhe nipin. "Floresha ka dy djem. Njëri ka ikur në Gjermani si azilant ekonomik. Ndërsa djali tjetër i ka vdekur, ndaj jetonte me nusen dhe nipin. Ndonëse e moshuar, Floresha ishte e mbajtur. Nuk e dimë se si ndodhi ngjarja që ajo humbi jetën. Mbase është rrëzuar dhe ka humbur jetën, mbase e kanë vvarë. Nipi i saj është 23-vjeç dhe ishte problematik", thanë fqinjët e viktimës.

vjeçares, e cila jetonte me nusen e djalit dhe nipin, i cili ishte përdorues droge. Policia e prokuroria e Durrësit janë duke punuar intensivisht për zbardhjen e rrethanave të kësaj ngjarje. Vetë 23-

vjeçari nuk ka pranuar autorësinë e krimin. **DËSHMIA E NIPIT**
Burime nga grupi hetimor pohan për "GSH" se nipi i 83-vjeçares së Floresha Shkurti nuk ka pranuar se

HETIMET

Nga hetimet e kryera ka rezultuar, se 23-vjeçari fillimisht ka njoftuar urgjencën dhe pastaj i ka telefonuar nënës së tij, e cila punon në një resort turistik tek plepat. "Lerë punën sot dhe hajde në shtëpi se ka vdekur gjyshja", mësohet t'i ketë thënë ai së ëmës. Sipas hetuesve të çështjes, i riu i ka telefonuar dhe një shoku të tij, të cilit i ka kërkuar ndihmë, duke i thënë: "Eja më ndihmo se kam një hall të madh". Hetuesit e çështjes sqaruan se është tentuar që të lëvizet kufoma dhe të prishen provat në vendngjarje

ka vvarë gjyshen e tij, Floresha Shkurtin. "I riu ka folur pak në lidhje me ngjarjen. Ai ka qenë kontradiktore në dëshminë e tij", thanë hetuesit e çështjes. Ndërsa, treguan se pas vrasjes të së

moshuarës, 23-vjeçari ka hyrë në dush është larë dhe ndërruar, ndërsa rrobati i ka futur në një kosh. Pas dushit ai ka njoftuar urgjencën dhe i ka telefonuar nënës dhe shokut të tij.

Policia, kontrolle në të gjithë qarkun e Fierit, 5 në pranga për drogë e vjedhje

Policia e Fierit ka ushtruar kontrolle të shumta në lokale nate, akse rrugore e ambiente të ndryshme në Fier, Patos e Roskovec. Kjo në kuadër të masave për kontrollin e terriorit, parandalimin e ngjarjeve kriminale, kapjen e autorëve të ndryshëm të veprave penale si dhe personave të shpallur në kërkim. Si rezultat i kontrolleve janë arrestuar 5 persona, 1 është proceduar në gjendje të lirë dhe 1 tjetër është shpallur në kërkim. Po gjatë kontrolleve u shoqëruan për verifikim 13 persona, kryesisht me precedent penal të dyshuar për "Shpërndarje të lëndëve narkotike" dhe për "Vjedhje". Sipas bluve gjatë kontrolleve u kapën në flagrancë 4 persona, të cilëve gjatë kontrollit fizik iu gjetën doza lëndë narkotike të dyshuara kanabis sativa.



Bëhet fjalë për shtetasit: D.D., banues në Roskovec; J.Ç., banues në Roskovec; M.H., banues në Roskovec dhe O.V., banues në Patos. Gjithashtu, u kap shtetasi i shpallur në kërkim: Petrit H., 27 vjeç, banues në Mallakastër për veprën penale "Vjedhje". Po në kuadër të kontrolleve të lokaleve, filloi procedimi pe-

nal për shtetasin: R.S., banues në Roskovec për veprën penale "Organizimi i lotarive të palejuara" si edhe u shpall në kërkim pronari i lokalit, shtetasi S.R. Ky fundit akuzohet për veprat penale: "Vënie në dispozicion të lokaleve për lojëra të palejuara" dhe "Organizim i lotarive të palejuara".

SHKURT

Arrestohet i kërkuari për trafik femrash në Itali

KRUJË - Policia e Krujës ka arrestuar një 50-vjeçar të shpallur në kërkim ndërkombëtar, i cili ishte dënuar me 6 vite e 3 muaj burg nga drejtësia italiane. Bëhet fjalë për Flamur Korrikun, banues në Tiranë, i cili u ndalua me qëllim ekstradimit drejt Italisë. 50-vjeçari është kapur në Fushë-Krujë, ndërsa është dënuar në vendin fqinj për veprat penale: "Organizatë kriminale", "Shfrytëzim prostitucioni", "Trafik femrash", "Krim kundër fëmijëve" si dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar në legjislacionin penal italian. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprimet të mëtejshme.

Shkodër, Gjok Jaku komandohet drejtor i Hipotekës

SHKODËR - Gjokë Jaku është drejtor i hipotekës së Shkodrës pas arrestimit të drejtorit të mëparshëm, Zamir Leka. Jaku mban postin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Hipotekës në Shqipëri. Duke parë situatën e fundit dhe vështirësitë në Hipotekën e Shkodrës pas rasteve korruptive dhe shkarkimit e arrestimit të disa zyrtarëve të këtij institucioni, drejtoria e përgjithshme ka vepruar menjëherë duke mos e lënë bosh vendin e drejtorit në Hipotekën e Shkodrës. Në këtë mënyrë Gjokë Jaku është prezantuar si kreu i ri në Zyren e Regjistrimit të Pasurive në Shkodër.



Kakavijë, kapet greku me 80 mijë euro në makinë

GJIROKASTËR - Një shtetas grek është kapur dje në pikën kufitare të Kakavijës, pasi në makinë iu gjetën 80 mijë euro të padeklaruar. Ngjarja në fjalë është regjistruar në orën 10:00, teksa shtetasi i huaj po tentonte të linte territorin shqiptar. "Policia Kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavije, sekuestroon 80 mijë euro një shtetas grek, i cili nuk i deklaroi në kufi. Shërbimet e Policisë Kufitare në dalje të Republikës së Shqipërisë, gjatë kontrollit në vijën e dytë të shtetasit grek G.S., 51 vjeç, banues në Patra, i cili udhëtonte në automjetin e shtetasit A.P., banues në Lezhë, shtetasit grek i gjetën dhe u sekuestroon një sasi prej 80.000 euro, të cilat nuk i kishte deklaruar në kufi. Po kryen veprimet procedurale nga specialistët për Hetimin e Krimin Ekonomiko-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjyrokastër", thuhet në njoftimin e policisë.

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga 'Agjencia'

ALUIZNI: 1500 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Lista me pronarët në qarkun e Tiranës

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 1500 personat kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Tiranës. Pronarët që kanë gati lejet janë në 11 njësitë e kryeqytetit dhe në zonat përreth. Përfituesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga AULIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë

për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Nderkohë që

sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të

cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitën poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin,

nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë

takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

EMER	MBIEMER	NJESIA
ARDIAN	HYSA	2
DALIP	RAMA	4
JORGJI	JANULLARI	3
ASLLAN	META	7
ILIR	MULEKU	4
SOKOL	VATAJ	4
GIJIN	GIJINI	11
DYLBËR	YMERI	4
RUZHDI	KURMAKU	3
FATMIR	EBIP	4
HASAN	DAMZI	11
ALUSH	ZIRA	9
ALBAN, DEZDEMONA	BALLA, BALLA	11
SHEFKI	TAFA	9
HYSEN	KURTI	6
NEXHMI	HYSA	9
MARK	VUKZA	11
MERITA	SINA	4
FATMIR	SUSAJ	11
BAJRAM	PLAKU	6
LORETA	BEGANI	4
SINAN	KAZANI	4
ISMAIL	LLESHI	9
REXHEP	PAPA	4
XHAFFER, AZGAN, HALIL	MALIAJ, DEMALIAJ, DEMAL	11
AFRIM	ALIAJ	6
ZEF	HASANAJ	11
LORETA	BEGANI	4
ERIND, NEVRAT	HASANLLARI, HASANLLARI	4
FATMIR, SONILA	CECOLLARI, CECOLLARI	11
MALIK, GAZMIR	LOCI, LOCI	9
FLORA, XHEZMI	LLAPANJI, LLAPANJI	4
LULEZIM	DURA	11
XHEZAR, PAJTIM	HYSLLARI, HYSLLARI	11
ARBEN	DURISHTI	4
MUSA	KABILI	4
ZAIM	VESELI	11
NDUE	LLESHI	4
FASLLI, LUMTURIE	MERA, MERA	4
LUMTURIE	GURTHI	4
RAMAZAN	AJAZI	4
VLADIMIR	DAKE	3
SHEFIK	CAUSHI	9
MYFTEREM	QAMILI	2
ALI	RAMA	11
XHEVAT	ISLAMAJ	4
BESNIK	ALLA	11
JYSEN, PANAJOT, VALTER	CELLARI, CACELLARI, CACELL	3
ENGJELL	MATA	3
HYSNI	ALLA	1
PREKE	PERPERAJ	11
BAJRAM	SINANI	4
DRITAN	HOXHA	3
ZIJA	KASEMI	1
SELIM	METRA	4

FEHMI	GJANA	6
ARBEN	BIGA	4
EDUARD	GJONAJ	4
GEZIM	BRUCI	4
FATMIR, SEFEDIN	XHAMBASI, XHAMBASI	4
ARBEN, ARDIAN	SULAJ, SULAJ	11
BASHKIM, HASAN	ISMALAJ, ISMAILAJ	9
PETRIT	MEMA	4
SHKELQIM	KAZANI	9
KUJTIM	MATOSHI	1
BUKURIE, HEKURAN	MANCILA, MANCILA	4
ESAT	REXHEPI	3
SHEFQET, ALI	MURATAJ, MURATAJ	11
FLAMUR	TOSKA	9
QAMIL	MANI	4
FIQIRI, BARDHYL	LULJA, LULJA	2
MIMOZA	ZYBERAJ	11
PERPARIM, RIZA	CANI, CANI	2
VIKTOR, GJOKE	VUKAJ, VUKAJ	4
EDUART	BALLA	4
AGIM	KRUJA	4
ALLAMAN, MENTOR, FESTIM	DOKU, DOKU, DOKU	11
ULVO, FJORELA, ENI, ALDO	BULLAJ, BULLAJ	3
FERIT	NDREGJONI	4
MAMUSH, ARDIAN	CUTARRAJ	4
KADRI	ALUSHI	11
IBRAHIM	LICI	7
VENDIM	HAJDARI	6
FADIL, SEIT, SPIRO	RAPCE	7
FEHIM, ARDIAN	MYRTOLLARI	1
FATMIR, RUDINA	PLAKU	11
QAMIL	NELI	3
SHKELQIM	GUJZI	4
HAJIM	BRIJA	11
TUSHE	LLUPA	2
FEJZO	LAMA	8
HAMZA	LILA	9
SAIMIR	GIJCI	4
ARJAN	SEJINI	11
MAKSUDE,	SADA	9
MUSTAFA, ADRIAN, ALFRED	VELCANI	4
DYLBËR	ALIAJ	4
NUREDIN	OSMANI	6
ILMI	BOSHKU	11
HYSEN	HOXHA	1
RAPI	MULLAMETI	11
ISA	MEMA	3
SELAM	ALLARAJ	9
BESNIK	PIPERI	7
NEVRUZ	NURA	4
QEMAL, MAKSI	STROKA, STROKA	3
SOKOL, GEZIM, AGIM, ...	CUNI, CUNI, CUNI, ...	11
KLAUDIO	HYSNBELLI	1
ARIFKE	ALLARAJ	9

ARBEN	MUCA	4
HEKURAN	LLAPUSHI	6
QEMAL	DOKA	4
besnik	cenë	4
muhamet, rexhep	LKA	4
FERIT	BOSHKU	11
ARTA	DRICI (FASLLIA)	4
SHKELQIM	GJOKA	11
FESTIM	META	4
ENGJELL	DURO	7
RRAPUSH	LENA	2
BAHRI	ZYBERAJ	9
BASHKIM, HASAN	PIPERAJ	7
PERPARIM	XHEKA	11
ARBEN	ALLARAJ	9
AHMET	POPSHINI	4
AQIF	XHAFA	2
PJETER	DEMAJ	11
VEHBI	DALLIU	4
RUSTEM	RRUSHI	11
FATJON, HATIXHE	XHABAFTI	2
LUAN	SHEHU	11
NEVRUZ	SHEHU	8
YMERLI, BANDILL	PLAKU	11
RESMI	HOXHALLARI	9
LAVDERIM	HOXHA	9
NURI	UKA	9
DRITAN	DEMOLLARI	4
KRISTAQ, RAMADAN	NELI	3
ILIR	MANSAKU	11
PLLUMB	ALLARAJ	9
PETREF	MAHMUTI	11
ALGERT	ZEQOLLARI	11
SHKELQIM	CELA	4
LEKE	MARTINI	11
AQIF	RRAFMANI	11
EMERLI	LITA	9
FIQIRI, BARDHYL	PLAKU	6
NAZMI	LACI	2
VANGJEL	LIKOLLARI	1
SULEJMAN, JANAQ	SULO, SULIOTI	6
FLORI	KACA	4
ANASTAS	HOXHA	4
ISMAIL	HAJRULLAI	4
PETRIT	URUCI	4
MUHAMET, SHKELQIM	TAHIRAJ	11
HITAJ	HITAJ	4
BEHAR	HOXHA	4
FATOS	ALLCIU	4
ARBEN	XHAFERRI	4
PASHK	MARKU	11
ASLLAN	BOGDANI	3
XHELAL	BEQIRI	4
SOKOL	COLLAJU	6

PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT

Table listing names and numbers of individuals who have their permits legalized. The table is organized into columns, with names and their corresponding numbers listed in a structured format.

PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT

Table listing names and identification numbers for individuals who have completed their permits and legalization. The table is organized into columns, with names and numbers on the left and right, and a central column for names and numbers. The list includes individuals from various regions and professions, such as KOLE BIBB KALA, AGRON HAMDI SKENDERI, and many others.

KËSHILLI BASHKIAK VENDIMET

Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Tiranës/ Hapen 2 qendra për njerëzit në nevojë

Bileta autobusi për fëmijët 0-6 vjeç, Veliaj: Kemi kërkuar të jenë falas

Organizata CRCA: Shkelje e të drejtave të vogëlushëve

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, është mbajtur mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës e cila është shoqëruar me debate të shumta nga ana e opozitës. Lidhur me debatin për pagesën e biletave të autobusit për fëmijët 0-6 vjeç, kryebashkiaku Erion Veliaj i konsideroi si hipokrite qëndrimet e opozitës mbi këtë çështje. "Autori i ligjit që detyron fëmijët të paguajnë biletën e autobusit është Lulzim Basha, e bëri në 2007. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj deklaroi sot gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak se ish-ministri i Transporteve dhe kryetari i PD-së, Lulzim Basha është autori i ndryshimeve ligjore që detyronte fëmijët nga mosha 0 deri në 6 vjeç të paguanin biletën e udhëtimit në transportin urban", tha Veliaj. Më tej ky i fundit sqaroi se administrata aktuale e Bashkisë Tiranë i ka kërkuar kompanive të transportit urban në qytetin e Tiranës që fëmijët e kësaj moshe të udhëtojnë falas në autobusët urban. Kjo pasi, sipas tij, qeveria e mëparshme e Partisë Demokratike e kishte hequr këtë detyrim për kompanitë me ligj, duke i lënë atyre dorë të lirë për të detyruar fëmijët që të paguanin biletën. "U ngrit një histeri për çmimin e biletës për fëmijët. Në fakt, ligjin e transportit urban në Republikën e Shqipërisë e ka bërë ish-ministri i Transportit, Lulzim Basha në vitin 2007, që ka hequr ligjin e kohës së Adil Çarçanit që thoshte nga 0 deri në 6 vjeç udhëtimi është falas. Bashkia jonë në kundërshtim me ligjin e Lulzim ministër i Transporteve i ka kërkuar në mënyrë të paligjshme nëse flasim në sensin juridik të këtyre profesorëve të Juridikut që sa bojkotuan mbledhjen. I kemi kërkuar ne në kontratë që fëmijët të udhëtojnë falas", tha kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

REAGIMI I ORGANIZATAVE CIVILE

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve Shqipëri (CRCA),



QENDËR E RE PËR TË PASTREHËT

Kryeqyteti do t'i shtohen edhe dy qendra që do të ofrojnë shërbime dhe mbështetje për shtresat në nevojë. Këshilli Bashkiak miratoi në mbledhjen e djeshme propozimin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj për ngritjen e qendrës sociale "Strehëza Tiranë", pranë ambienteve të ish-uzinës së autotraktorëve në Shkozë, e ideuar për t'i ardhur në ndihmë personave të pastrehë të ndodhur në situatë rruge.

NGRIHET QENDRA "GONXHE BOJAXHI"

Gjithashtu, Këshilli Bashkiak miratoi ngritjen e Qendrës Komunitare "Gonxhe Bojaxhi", për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të njësive administrative nr. 4 dhe 8. Kjo qendër do të shërbejë për informimin dhe zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë këtë komunitet, por do të shërbejë edhe si një qendër për zhvillimin e aktiviteteve për komunitetin.

TERMINALI I RI MODERN I AUTOBUSËVE

U miratua vendimi "Për miratimin në parim të studimit të fizibilitetit dhe të kontratës të partneritetit publik privat "Për hartimin, ndërtimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e terminalit të transportit publik në Tiranë". Kryetari i Bashkisë së Tiranës u shpreh se për herë të parë Tirana do të ketë një terminal autobusësh modern, ndërsa theksoi se veç tij do të ketë edhe një tjetër terminal në lindje të qytetit.

100 KËNDE LOJËRASH MANDATIN TJETËR

Veliaj theksoi se Tirana falë punës së bashkisë është një qytet që i kushton shumë rëndësi të ardhmes, pra fëmijëve. "Sapo mbyllem këndin e 35 të lojërave, synimi ynë do të jetë që në mandatin tjetër të mundësojmë 100 kënde lojërash. Synimi është për t'i bërë fëmijët qytetarë më të mirë. Ndaj, këndet e lojërave nuk janë vetëm vendosje e ca lodrave me ngjyra nëpër cepa bosh, por janë investim për kulturën e re të qytetarëve të rinj të Tiranës", tha ai.

Koalicioni për Arsimin në Shqipëri (ACE), si dhe Rrjeti Kombëtar "Vepron për Fëmijët", kanë ngritur edhe një herë shqetësimin e tyre në lidhje me çmimin e biletave në transportin urban për fëmijët. Në deklaratë theksohet se një sërë raportesh të fundit nga media tregojnë se fëmijëve po

iu kërkohej të paguhet çmimi i biletës për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas njësoj si të rriturit. "Gjendja paraqitet tepër shqetësuese sidomos në bashkitë ku ka transport publik të organizuar dhe funksional. Ligji për transportin i vitit 1998 (me ndryshime në vitin

2014) nuk cakton detyrimin e bashkive për të ofruar tarifa më të ulta për transportin publik për fëmijët, megjithatë praktika e zakonshme kudo në Shqipëri ka qenë që fëmijët të paguajnë gjysmën e çmimit të biletës së të rriturive", thotë CRCA në reagimin e saj. Më tej kjo organizatë thekson se

raportet më të fundit tregojnë se kjo praktikë është eliminuar tërësisht pasi Këshilli Bashkiak nuk kanë krijuar asnjë mundësi që fëmijët të përdorin transportin publik ose falas ose me tarifë të reduktuar. "Shteti shqiptar ka për detyrë të mbrojë pa paragjykim të drejtat e fëmijëve të sanksionuara në Kon-

ventën për të Drejtat e Fëmijës së OKB-së dhe nga ligjet e tjera të vendit. Shkelja e të drejtës së lëvizjes së lirë të fëmijëve sjell si pasojë edhe shkelje të tjera të rënda të të drejtës së fëmijës, si të drejtën për jetën, shëndetin, arsimin, dhe mirëqenien e tyre", nënvizohet në deklaratë.

VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK:

- Vendimin "Për propozim për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30.9.2018";
- Vendimin "Për miratimin e pagesës për PAK dhe Invalidët e Punës, për periudhën 1-30 shtator 2018";
- Vendimin "Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese, për periudhën 1-31 gusht 2018";
- Vendimin "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1-31 gusht 2018";
- Vendimin "Për miratimin e sistemit të fëmijës, Azvaldo Çeça, në institucionet e përkujdesjes shoqërore";
- Vendimin "Për miratimin e projektit "Të rinj dhe të reja drejt një profesioni", hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij";
- Vendimin "Për zbatimin e projektit "Programi i nxitjes së punësimit të biznesit rinor", hartuar sipas Udhëzimit Operacional për zbatimin e këtij projekti";
- Vendimin "Për miratimin e draft- kontratës së qirasë dhe akt marrëveshjes tip që do të lidhet midis Bashkisë Tiranë dhe debitorëve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës ish fonderia Mekanike";
- Vendimin "Për përcaktimin e vlerës maksimale e minimale të qirasë sipas strukturave të apartamenteve dhe të vlerës maksimale e minimale të të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira, në kuadër të projektit "Ndërtimi i banesave me qëllim social, në zonën e Shkozës, ish Fonderia Mekanike";
- Vendimin "Për miratimin e strategjisë së artit dhe kulturës për Bashkinë Tiranë 2019-2024";
- Vendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatshëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018 (i ndryshuar)";
- Vendimin "Për mbështetje financiare nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë të Tiranës";
- Vendimin "Për dhënie e ndihmës financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, për disa familje që banojnë në territorin administrativ të bashkisë Tiranë";
- Vendimin "Për dhënie e pëlqimit për vendosjen e skulpturës së Papa Gjon Pali II-të, në rrethrotullimin e rrugës "Papa Gjon Pali i II-të", pranë stadiumit "Qemal Stafa".

Rihapet shkolla e re në njësinë 8, përdorej për zyrat e Ujësllësit

Këshilli Bashkiak gjatë mbledhjes së djeshme, diskutoi edhe një tjetër vendim të rëndësishëm, nëpërmjet të cilit rihapet një shkollë në njësinë 8, të cilës administrata e kalendarit e Bashkisë së Tiranës, i kishte ndryshuar destinacionin, duke e kthyer në zyra për ndërmarrjen e Ujësllësit-Kanalizimeve. "Njësia 8 i ka dhënë mandatin e kalendarit edhe për kryetar, edhe për nënkryetar të Bashkisë, Lulzim dhe Jorida. Por, prona të Medreseja, ku sot ka zyrat UKT-ja, në fakt, në versionin e vet origjinal ka qenë shkollë. Saliu, ngaqë i fallimentoit të gjitha kompanitë, filloi t'i degjiste nëpër bashki dhe Bashkia i çoi zyrat e UKT-së në një shkollë, të Medreseja për njësinë 8. Ne sot duam të marrim vendimin për ta çuar UKT-në të inkubatori i biznesit dhe të lirojmë një shkollë për Njësinë 8", tha Veliaj.

KOSOVA NE OKB DEBATET

Thaçi: Amerika konfirmoi se na mbështet në marrëveshjen me Serbinë

SHBA mbështet Kosovën, Trump: E njohim problematikën

Presidenti kosovar takon Erdoganin në Nju Jork

Gjatë takimeve të bëra javën e kaluar në Nju Jork në Asambleenë vjetore të OKB-së, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se gjatë takimit që ka pasur me Presidentin Trump i ka thënë se Kosova është një vend i mrekullueshëm me një popull të mrekullueshëm dhe e ndjen dhe e njeh problematikën e Kosovës. Në një prononcim për "RTK", presidenti po ashtu tha se në takimet që ka pasur me sekretarin Mike Pompeo dhe ambasadorin e SHBA-ve në OKB, ishte një ndjejnë e fuqishme me mbështetje për Kosovën, ku u shpreh qartë se administrata "Trump" mbështet Kosovën dhe rrugëtimin më të shpejtë për në NATO. Presidenti Thaçi po ashtu pohoi se SHBA-të mbështetin fuqishëm dialogun Kosovë-Serbi dhe marrëveshjen e mundshme historike që mund të arrihet mes dy vendeve. "SHBA konfirmuan qartë se e mbështetin edhe angazhimin që kemi deklaruar, në rast të arrijtes së marrëveshjes mes të Kosovës dhe Serbisë, ku mund të përfshihet demarkimi i kufirit dhe korrigjimi i lehtë i kufirit, që do të mbyllte urretjen ndërshkulllore mes Kosovës dhe Serbisë", deklaroi presidenti Thaçi. Ndërkaq, z. Thaçi ka zhvilluar një tjetër takim me homologun e tij turk, Erdogan. Agjencia turke e lajmeve "Anadolu Agency", ka raportuar se presidenti Erdogan është takuar me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi në Nju Jork. Në takim kanë qenë të pranishëm edhe ministri i Tregtisë Ruhsar Pekcan, ministri i Shëndetësisë Fahrettin Koca, shefi për marrëdhënie me opinionin në Kabinetin e Presidentit të Turqisë, Fahretin Altun dhe zëvendës kryetari i partisë AKP, Cevdet Yılmaz. Takimi i mbyllur për media është mbajtur në hotelin "Peninsula". Në Nju Jork u mbajt seanca e 73-të e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, që njëherësh është një rast për shumë takime bilaterale të liderëve botërorë. Ndërkaq, ditën e martë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj deklaroi se, "roli i NATO-s në Kosovë ishte jetik për popullin tonë në kohë lufte, kontributi i së cilës vazhdon edhe në ditët e sotme". Situata politike dhe e sigurisë në vend dhe rajon, progresi i arritur në Kosovë, me theks të veçantë procesi i tranzicionit i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura, si një forcë multietnike, profesionale dhe sipas standardeve të NATO-s, ishin disa nga temat e këtij takimi. Haradinaj kërkoi mbështetje nga Sekretari i Jens Stoltenberg dhe institucionit që ai drejton. "Institucionet dhe populli i Kosovës e vlerësojnë lartë rolin e NATO-



HASHIM THAÇI
"SHBA konfirmuan qartë se e mbështetin edhe angazhimin që kemi deklaruar, në rast të arrijtes së marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë, ku mund të përfshihet demarkimi dhe korrigjimi i lehtë i kufirit, që do të mbyllte urretjen ndërshkulllore mes Kosovës dhe Serbisë".



Bashkëpunëtori i Merkelit: Nëse ndahet Kosova, do të ketë luftë!

Vijojnë ende debatet dhe komentet lidhur me korrigjimin e mundshëm të kufijve Kosovë-Serbi. "Nëse ka një ndarje të Kosovës, do të ketë luftë!", ky është një paralajmërim i Gjermanisë dhe Anxhela Merkelit e thënë nga goja e njeriut që konsiderohet dora e djathtë e kancelares, Norbert Roetgen, raportori portali serb "Serbija danas". Mesazhi i qartë është dërguar Beogradit dhe Prishtinës, por sigurisht dhe Donald Trumpit dhe administratës së tij në Uashington. Dokumentin, përmbajtja e të cilit është bërë publike, ai e ka përpiluar së bashku me Robert Kuper, një ish-mbikëqyrës në dialogun teknik autoriteteve të Serbisë dhe të Kosovës. Raporti thuhet se ka tri faqe, ku përmendet drejtpërdrejt një konflikt i mundshëm i armatosur. "Ndryshimi i kufijve në Kosovë me siguri nuk do të kalojë pa dhunë, ajo nuk mund të kryhet në mënyrë të qetë dhe do të çojë në emigrimin e serbëve. Ky është vetëm një nga citatat e raportit të përpiluar nga Roetgen dhe Kuper.

SHKURT

Ndjek avionin në pistë se humb fluturimin, arrestohet 20-vjeçari

Një pasagjer është ndaluar nga policia në Aeroportin e Dublinit, pasi po vraponte në pistë drejt avionit duke thirrur pilotin që të ndalonte për ta pritur. Incidenti ndodhi rreth orës 7 të mëngjesit këtë të enjte. I riu, i cili mendohet të jetë rreth të 20-tave, fillimisht shkaktoi kaos në terminal duke iu kërkuar punonjësve të aeroportit që të mbanin avionin. Ai më pas vrapoi për në pistë duke shkruar pranë avionit të "Ryanair" para se policia ta arrestonte. Një punonjës i aeroportit tha se i riu i cili mendohet të jetë irlandez, vrapoi nga ndërtesa drejt avionit, që po bëhej gati të fluturonte për në Amsterdam. Ai u arrestua dhe pritet të paraqitet në Gjykatën e Dublinit për t'u përballur me akuzat lidhur me aksidentin.

Tenton të shpëtojë vëllezërit nga zjarri, vdes 12-vjeçari

Një djalë i mitur ka vdekur nga zjarri ndërsa po përpiqej të shpëronte vëllezërit e motrat e tij, duke mos e ditur që ata kishin dalë nga shtëpia që po digjej. Adrian Kros, 12 vjeç, humbi më 24 shtator kur u bllokua në katin e dytë të shtëpisë së djegur në SHBA. I mituri hyri brenda për të shpëtuar vëllezërit e tij, pasi nuk e kishte kuptuar që familja e tij kishte dalë jashtë dhe ishte në gjendje të mirë shëndetësore. Shërbimi i zjarrfikës mbërriti në vendngjarje, por thanë se flakët ishin përhapur shumë brenda një kohe të shkurtër. Autoritetet po hetojnë për të përcaktuar shkaku të zjarrit.

Daçi: Gjithçka që bëjnë shqiptarët, mëngjes i vonë

Kryeministrja Bërnabiç në OKB, media serbe: Trampi ka ndryshuar qëndrimin për Kosovën

Ljiljana Bërnabiç, ministri i Jashtëm serb, i ka cilësuar të turpshme veprimet e përfaqësuesve të Kosovës në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork. Daçi ka deklaruar se Prishtina në Nju Jork ka dërguar 41 përfaqësues, ndërsa delegacioni serb i kryesuar nga kryeministrja, Ana Bërnabiç, ka dhjetë anëtarë, transmeton "Lajmi.net". Ministri i Jashtëm serb theksoi se delegacioni i Prishtinës nuk ishte i ftuar zyrtarisht në takim me kryeministrin e Marokut. "Nëse shikoni në "Twitter", mund të shihni lajme të ndryshme, edhe takime nëpër korridore. Ishte një turp i madh kur kryeministri maroken, Pacoll i u afrova dhe më pas s", tha kryeministri Haradinaj. KFOR-i në Kosovë është kontribut për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në këtë pjesë të Evropës Juglindore. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg pohoi se NATO do të ofrojë përkrahje për Kosovën edhe në të ardhmen.



shkroi se kishte diskutuar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Gjithçka që shqiptarët bëjnë është mëngjes i vonë", ka ironizuar Daçi. Ndërkaq, mediat serbe raportojnë se presidenti i SHBA-ve, Donald Trump ka ndryshuar qëndrimin për Kosovën. Sipas gazetës së Beogradit "Blic", Trump "personalisht

e ka konfirmuar ndryshimin e politikës amerikane lidhur me çështjen e Kosovës". Teksa i ka cilësuar serbët si njerëz të mirë, Trump, sipas kësaj gazete përkrah vazhdimin dialogut dhe çdo kompromis që do të arrihet nga të dy palët. "Në bisedën e shkurtër të të përzemërt, kryeministrja serbe Ana Bërnabiç e ka falënderuar Trumpin për ndryshimin e qëndrimit të administratës së tij lidhur me çështjen e Kosovës", shkruan "Blic". Ndërkohë, kryeministrja serbe tha për takimin me Trumpin e: "Nuk mund të them se pata kohë, por e falënderova për botëkuptimin e rindaj Serbisë dhe të qëndrimit tonë".

Shoqëria permbirimore JUSTITIA

shpall ankandin, faza DYTE, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Tualik Ndërtës me sip. totale prej 250 m2, nga ku tualik 250 m2, dhe ndërtesë 101 m2, nr. pasurie 9/383, Vll. 16/fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheqer Madh" Fir, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.640.000 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 25.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria permbirimore JUSTITIA

shpall ankandin, faza e parë për shitjen e pasurisë së paluajtshme sipas Çertifikatës provizore për regjistrimin karabina: Pasuri e paluajtshme, Apartament me sipërfaqe 70m², e regjistruar në regjistrin hipotekor me Nr.17, datë 28.04.2009, me Nr. Pasurie 6/2+1-1, në Zonën Kadastrale 3126, me Adresë: Shëngjin, Lezhë, regjistruar në emër të Shaban Elezi dhe Taze Smajal, hipotekuar në favor të BKT BANK.
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 2.400.000 (dy milion e katërqind e njëzetë mijë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 16.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890/ 0693177499

LUANA VJOLLCA I BËN 'ZBOR' FOTOSHOPIT

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premte 28 Shtator 2018



Fanset pyesin për make-up-in, përgjigjja e Marinës do ju befasojë



Modelja e njohur jep lajmin për martesë, ja reagimet e fansave

BULEVARDI
POLITIK



- Frikë nga helmimi? Mogherini i refuzon çajin zyrtarit rus
- Kryetari i FRESH publikon foton e të vëllait me Ballën, deputeti: Bobo
- Pas 6 muajve larg kamerave, Kate Midleton i rikthehet punës
- Pas lapsusit të ministres, edhe deputetes Hysi i merret keq goja



Marina Vjollca larg Shqipërisë, pushime luksoze në vende piktoreske

Sezoni i ri televiziv, ja kush janë prezantueset që ngelën jashtë ekranit

Jona Spahiu i përkushtohet familjes

MARINA VJOLLCA LARG SHQIPËRISË, PUSHIME LUKSOZE NË VENDE PIKTORESKE

Sezoni i ri televiziv, ja kush janë prezantueset që ngelën jashtë ekranit

Jona Spahiu i përkushtohet familjes

Egla Xhemali

Sezoni i ri televiziv ka nisur tanimë dhe janë konfirmuar lëvizjet, ikjet dhe prurjet e reja. Janë bërë me dije shumica e emisioneve dhe protagonistët, por ka edhe disa emra të njohur moderatorësh që kanë mbetur ende pa asnjë projekt televiziv.

MARINA VJOLLCA

Më e përfolura e momentit është Marina Vjollca. Prezantuesja që ka realizuar një sezon të spektaklit "C'est la vie" në Tv Klan, ndonëse bëri shumë bujë me largimin nga "Top Channel", televizion ku ajo filloi karrierën, nuk dihet çfarë projekti do ketë këtë sezon. Duke qenë se akoma nuk ka një angazhim të vetin në televizion moderatorja së bashku me Getoarin nuk i kanë mbyllur ende pushimet. Ata janë duke lëvizur në vende më piktoreske të botës. Vjollca ka qenë në Kuba, Miami, Las Vegas. Aktualisht po shijon ditët e relaksit në Bahamas nga ku ndanë çdo ditë imazhe në rrjetet sociale.

ARJOLA SHEHU

Arjola Shehu mesa duket ua ka marrë dorën lëvizjeve. Ish-prezantuesja e InTV drejtoi për një sezon emisionin e drekës në Tv Klan "Kush vjen për drekë", një show ky argëtues në gatim, por jo vetëm mes VIP-ave. Shehu ishte, gjithashtu, prezantuese krah Arditit dhe Nevina Shtyllës tek në festivalin "Kënga Magjike". Mirëpo Arjola nuk shihet gjëkund këtu sezon. Vizita e saj në Top Channel u përkthye në media si një lëvizje, por deri më tani moderatorja nuk ka konfirmuar asgjë. Ajo që dihet është se orari i transmetimit që Shehu kishte në Klan, i është besuar dy shefave të njohur Alfio Rrotani dhe Indrit Çela. Mesa kemi mësuar, tematika e emisionit do të jetë pak a shumë e njëjtë ku në thelb do të jetë gatimi, ndonëse shefat do të kenë veçoritë e tyre.



FJORALBA PONARI

Para pak kohësh u konfirmua se "Procesi Sportiv" në këtë sezon të ri televiziv Edi Manushi do të ishte mes dy bukursoheve, Fjoralba Ponari dhe Nevina Shtyllës. Mirëpo mesa duket ky lajm nuk ishte i vërtetë pasi Fjoralba nuk do të jetë prezantuese në "Procesin sportiv". Edi Manushi do e drejtojë emisionin vetëm me Nevina Shtyllën, e cila u

largua nga emisioni "Jo vetëm modë" në Tv Klan. Pas shumë thashethemeve Fjoralba vendosi që të japë disa detaje për emisionin në të cilin do të shfaqet. Njëpërmjet në videoje të shpërndarë në llogarinë e saj në rrjetet sociale u la të kuptohet se Ponari do të "The voice kids", duke lënë të kuptohet se do të jetë në një emision që ka lidhje me fëmijët dhe muzikën. Sa i përket pyetjes se kur



do shfaqet në ekran, moderatorja është përgjigjur: "Është zyrtare! Javën e fundit të tetorit!".

JONA SPAHIU

Pak ditë më parë prijtes së ëmbël të Jona Spahiut i erdhi fundi. Moderatorja e njohur solli në jetë një djalë që u quajt Raiden. Ndjesia e të qenit nënë mesa duket do e mbajë larg shfaqjes në ekran. Jona është bërë

mjaft e dashur për publikun, që kur prezantonte emisionin "Select" në Top Channel, për të vazhduar me emisionin "Pa Filter", ku intervistonte personazhe të njohura. Moderatorja nuk ka pohuar asgjë në lidhje me daljen e saj në ekran këtë sezon. Ndoshta është një vendim personal që t'i përkushtohet më shumë familjes dhe vogëlushtit që sapo ka ardhur në jetë.



Fanset pyesin për make-up-in, përgjigjja e Marinës do ju befasojë

Marina Vjollca është padyshim një prej vajzave më simpatike dhe të kuruara të ekranit. Dhe jo vetëm në televizion, por dhe në fotot e postimet e saj në rrjetet sociale, Marina duket gjithmonë perfekte. Kjo i ka shtyrë vajzat ta pyesin se si ka mundur që është gjithmonë kaq e kuruar.

"Një pyetje kisha. Ke marrë edhe stilisten personale me vete apo make-up-n e bën vetë? Në foto ke imazh perfekt",-e ka pyetur një komentuese. Pa hezituar fare, Marina ka shkruar "Vetë fare".



'Vajzë për shtëpi', nuk do ta besoni çfarë di të bëjë Oriola Marashi

Oriola Marashi është një nga modellet më seksi shqiptare. Ajo nuk ka në plan t'i lëri postimet provokuese, megjithëse këtë herë vjen krejt ndryshe. Oriola, vajza e pasarelave tashmë zhvendoset në kuzhinë për të ëmbëlsuar stomakun, ndërsa deri më tani sytë ju kanë parë gjëra të bukura prej saj. Nuk e dinim që anëtarja e OTR ishte e zonja dhe në bërjen e ëmbëlsirave dhe kjo vërtetohet më së miri me postimet e saj të fundit.



Modelja e njohur jep lajmin për martesë, ja reagimet e fansave

Ajo është një prej figurave më të komentuar e më të dashura për publikun shqiptar. Bëhet fjalë për modelen Anna Lika. Ajo ka një numër të madh ndjekësish në profilin e saj në "Instagram", ku me fansat e saj ndan momente të ndryshme nga përditshmëria e saj. Por së fundmi aktorja i ka habitur të gjithë me një postim që ka bërë në "Instastory", ku shkruan se shumë shpejt do të martohet. Një fans i saj ka një kërkesë për aktoren, pasi i thotë "na bëj i dasmë". Për këtë arsye Anna ka postuar një foto të një femre të veshur me fustanin e nusërisë dhe me buqetë në dorë.



Luana Vjollca i bën 'zbor' fotoshopit

Luana Vjollca është një nga moderatorët më të suksesshme të ekranit. Përveç talentit ajo ka bërë për vete shumë fansa me format e saj thuajse perfekte. Që në fillimet e saj është aluduar se ajo ka kryer ndërhyrje në trupin e saj, por ajo e ka mohuar këtë gjë sa herë është pyetur nëpër intervista. Nuk e mohojmë dot faktin se ajo është e bukur dhe format e saj janë bombastike por duket se në foton e saj të fundit i ka rrëshqitur dora paksa me fotoshopin. Le të kujtojmë se së shpejti ajo do t'i rikthehet në ekran me emisionin e saj 'Shiko kush luan'.



Frikë nga helmimi? Mogherini i refuzon çajin zyrtarit rus

Përfaqësuesit e lartë të Bashkimit Evropian zhvilluan një takim me homologët e Kremlinit në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara ku zhvillohet Asambleja e Këshillit të Sigurimit. Në mbledhjen e kryesuar nga ministri i Jashtëm, Sergei Lavrov, mori pjesë edhe Federica Mogherini, që ka tërhequr vëmendjen me gjestin e saj. Përfaqësuesja e lartë për Politikë të Jashtme të BE-së nuk ka pranuar një filxhan me çaj, të cilin ia ka ofruar një diplomat rus. Në këtë takim u diskutuan marrëdhëniet e Rusisë me Bashkimin Evropian. Nuk dihet pse Mogherini e ka bërë një gjest të tillë, por kohët e fundit rusët akuzohen të kenë gisht në disa helmime, përfshi këtu edhe atë të ish-spiunit Skripal në Salisburj të Anglisë.



Kryetari i FRESSH publikon foton e të vëllait me Ballën, deputeti: Bobo

Eljo Hysko, kryetari i FRESSH, njëherazi vëllai i moderatorit Turjan Hysko ka publikuar këtë foto të të vëllait me kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, i cili prej ditës së djeshme është kryefjalë e medieve 'online', pas denoncimit të komisar Emiljano Nuhut. "Po gërmoja fotot e verës dhe rastësisht pash që në 21 korrik një fans i Turit më kishte dërguar këtë foto live nga Pogradeci", shkruan Eljo Hysko. Foton, kryetari i FRESSH, ia ka dërguar edhe Ballës, i cili duket i pakënaqur me këtë "selfie". "Bobo", shkruan Balla.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Pas 6 muajve larg kamerave, Kate Middleton i rikthehet punës

Gjashtë muaj larg aparateve dhe kamerave, dukeshja e Kembrixhit, Kate Middleton është gati për t'u rikthyer në impenjimet e saj mbretërore. Që pas lindjes së djalit të dytë, Louis, ajo u është dedikuar totalisht tre fëmijëve të saj. Dukeshja e Kembrixhit pas lindjes së fëmijës së tretë, Louis, në 23 prill, kishte vendosur të merrte një pushim leje lindjeje, duke u shfaqur vetëm në dy raste, dasmën e Princ Harry dhe Meghan Markle dhe ditëlindjen e mbretëreshës. Por mesa duket, tani nëna edhe e dy fëmijëve të tjerë, princit George, 5 vjeç dhe princeshës Charlotte, 3 vjeçe, është gati për angazhimet e saj. Më 2 tetor do të jetë në një shkollë në Londër. Ndërkohë, në këto muaj mungesë të Kate ka qenë Meghan Markle, ajo që ka bërë praktikë për jetën e saj të re mbretërore.



Pas lapsusit të ministres, edhe deputetes Hysi i merret keq goja

Një lapsus që u përhap masivisht në rrjetet sociale duke shkaktuar mjaft të qeshura ishte ajo e ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Gjatë fjalës së saj në Kuvendin e Shqipërisë, ministrja ndau me rrokje dhe me një ndalesë të theksuar fjalën "karshi". Por një tjetër lapsus ka bërë deputetja e Partisë Socialiste, Vasilika Hysi. Teksa merrte pjesë në konferencën ndërkombëtare për shkallën e trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e Ballkanit, deputetja Hysi ka ngatërruar fjalën "kalvar"...



AMBASADA AMERIKANE LOTARIA AMERIKANE

Ambasada Amerikane: Nis më datë 3 tetor deri më 6 nëntor. Kriteret për të pasur mundësi fitimi

Kur fillon aplikimi për Lotarinë Amerikane

Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë

Fillimi i muajit tetor shënon edhe peri udhën kur hapen aplikimet për Lotarinë Amerikane. Dhe me afrimin e këtij muaji, ka ardhur në rritje edhe interesi i qytetarëve për më shumë informacion. Nisur nga kjo, Ambasada Amerikane në vendin tonë, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", njofton se aplikimet fillojnë nga data 3 tetor, ora 18:00 deri në datën 6 nëntor 2018, ora 18:00.

Duke filluar nga data 3 tetor, ora 18:00 deri në datën 6 nëntor 2018, ora 18:00, ju mund të aplikoni për Lotarinë e Vizës së Shumëllojshmërisë! Vazhdoni të na ndiqni në këtë faqe për të marrë këshilla mbi plotësimin e aplikimit tuaj. Këshilla ime e parë për ju është që të hapni faqen tonë të internetit dhe të lexoni udhëzimet e këtij viti. Ato janë të përkthyer në shqip! **UDHEZIMI**

Bëni kujdes nga mashtrimet. Disa faqe interneti apo emaille përpiqen t'ju mashtrorin duke u prezantuar si faqe zyrtare të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Plotësojeni vetë aplikimin tuaj. Aplikimi online për regjistrimin për lotarinë është i thjeshtë dhe është falas.

Periudha e Regjistrimit Elektronik për Lotarinë DV-2020

Regjistrimi elektronik për lotarinë DV-2020 do të rifillojë të mërkurën, më 3 tetor 2018 në mesditë 12:00. Ora Ditore Lindore (EDT) (GMT-4) dhe do të mbyllet të martën, më 6 nëntor 2018, në mesditë 12:00 Ora Standarde Lindore (EST) (GMT-5).

Shikoni videon tonë për një vështrim të përgjithshëm të programit të Vizave të Shumëllojshmërisë, si dhe udhëzimet hap pas hapi për t'ju ndihmuar se si të plotësoni një aplikim për t'u regjistruar për Lotarinë. (Shënim: ndryshime të vogla janë bërë në formularin e regjistrimit DV-2020, por udhëzimet e dhëna në video janë ende të vlefshme.)

Aplikantët mund të kryejnë aplikimin elektronik në faqen zyrtare të E-DV, gjatë periudhës së regjistrimit. Udhëzimet e DV janë, gjithashtu, në dispozicion në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit.



SI VERIFIKOHET NESE KENI FITUAR

Duke filluar nga 7 maji 2019, për të parë nëse janë përzgjedhur, të regjistruarit e DV-2020 do të mund të përdorin numrin e tyre unik të konfirmimit të dhënë në regjistrim duke kontrolluar online Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve në faqen zyrtare të E-DV-së. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të informojë pjesëmarrësit e përzgjedhur se si të aplikojnë për vizën e Lotarisë për veten e tyre dhe anëtarët e familjes së tyre. Të përzgjedhurit do të mund të mësojnë datën e tyre të intervistës për vizë duke hyrë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve.

KRITERET E ARSIMIT DHE PUNËSIMIT

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimin apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së.

Arsimimi: Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë që është i barasvlefshëm me ar-

simimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4 vjeçare, me kohë të plotë, arsim i përgjithshëm). Diplomat e shkollës së mesme gjimnaz me kohë të plotë kualifikohen për lotarinë. Shkollat e mesme profesionale me kohë të plotë mund të kualifikohen nëse ato në thelb përputhen me kërkesat thelbësore të një të arsimit të mesëm me kohë të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendimi përfundimtar do të merret nga oficeri konsullor në ditën e intervistës për vizë.

Diplomat e shkollës së mesme me kohë të pjesshme - pa shkëputje nga puna, sh-

kollat e natës ose ato me korrespondencë, përfshirë programet pesë vjeçare ose programet e gjata (me kohë të pjesshme, pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose me korrespondencë) nuk kualifikohen për programin e lotarisë. Edhe nëse ju keni mbaruar një pjesë të shkollës së mesme në sistemin pa shkëputje nga puna dhe pjesën tjetër në sistemin me kohë të plotë, kjo diplomë nuk kualifikohet për programin e lotarisë.

Diplomat universitare kualifikohen për programin e lotarisë së DV-së.

Punësimi: Aplikantët që nuk përbushin kriterin e

KRITERET

Udhëzimet për përgatitjen me vizë për të përzgjedhurit e vizave të Lotarisë

Përpara intervistës tuaj për vizë, ne ju rekomandojmë të rishikoni të dhënat që keni dhënë në aplikimin tuaj fillestar për lotarinë. Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci). Përgjithësisht bënë rastet kur bashkëshorti është Nënshkruar Amerikan, ose Banor i Përhershëm i Ligjshëm. Gjithashtu, ju duhet të kishit përfshirë të gjithë fëmijët tuaj të pamartuar dhe nën 21 vjeç në momentin e aplikimit fillestar. Me fëmijë nënkuptohen fëmijët tuaj biologjikë, dhe thjeshtërit- fëmijët e bashkëshortit/es tuaj, apo fëmijë që i keni bërëur ligjërisht, pavarësisht nëse jetojnë me ju ose jo. Sigurohuni që ju keni ngarkuar fotografinë e saktë për çdo pjesëtar të familjes në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë. Ngatërrimi i fotografive në aplikimin fillestar do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj.

Mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin tuaj për vizë nuk rimbursohet. Nëse në momentin e aplikimit fillestar, ju nuk keni përfshirë një fëmijë ekzistues, apo një bashkëshort/ e me të cilën ishit i martuar (pra, statusi tuaj civil ishte "i martuar" në momentin e aplikimit fillestar), atëherë mos vazhdoni me procedurën e aplikimit për vizë. Ju mund të rishikoni kriteret e pranueshmërisë online

arsimimit, duhet të përbushin kriterin e përvojës në punë për dy vjet në një profesion që kërkon të paktën dy vjet trajnim apo përvojë brenda një periudhe pesëvjeçare menjëherë para aplikimit. Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë.

Për t'u kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e

eksperiencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart. Profesionet kualifikuese të DV-së janë të renditura në Bazën e të dhënave të Departamentit të Punës O*Net-Online Database.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbarrimore "Best 2019"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë **19 tetor 2018** nga ora **08.00-ora.16.00** tek kjo zyre përmbarrimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e l-rë, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq 39, ZK.8350, sip. 103.90 m² me gmin fillestar 81.600 lek/m².

Apartmenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: **052226000**
ose cel: **0692075 644**

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZRYA PERMBARRIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË': VOLLUMI 1, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPERFAQJE 4.453 m², NË ADRESËN: XHAFZOTAJ, DËRRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,

ÇMIMI 17.812.000 LEKË.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.10.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866

Njoftim për shitje me ankand te dyte

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e dorëzuesit K S të ndodhur në Panshtrë Mallakastër. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga: Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m² ZK 2869 Mallakastër me çmim 840.000 leke. Pasuria "Are" nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m² ZK 2869 Mallakastër, me çmim 56.000 lek/Pasuria me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m² e ndodhur në ZK 2869 dhe ndodhet në Mallakastër me çmimin në masën 280.465 leke. Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet dt 18.10.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishita" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 67282543, e-mailit ilir_dervishi@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com

FESTIVALI MBARËKOMBËTAR

ZAMIRA KITA

Po në një mendje me Miho Gjini dhe me tërë ata që duan të shohin veten para pasqyrës, për të mos thënë të tërë jemi artistë të 'mrekullueshëm', ishte Zamira Kita, aktore e drejtore e Teatrit të Korçës. "Nuk mund të flasim ne për shfaqjet. Të jemi të sinqertë, është keq t'i bëjmë furça një-tjetrit. Ne kemi një teatër mesatar e mediokër. Kemi aktorë të mirë, që e mbajmë skenën dhe aktorë që janë jashtë komplet. Le të më gjykojnë kolegët e le të më futin kokën në dhe, nëse unë nuk e bëj si duhet këtë punë. E pëlqen publik? Po publiku merr atë që i japim ne. Se mund të dalë një të zhvishet dhe urra shkojnë e shohin të tërë, pro kjo nuk do të thotë se pati vlera".



Debat artistik për Festivalin Mbarëkombëtar, Kita: Le të më kritikojnë

Gongo: S'kemi ardhur këtu të gjykojmë kolegët, nuk vihen trupat para togës

MIHO GJINI

"Për Vlorën dua të them dy fjalë, përgjithësisht pozitive. Festivali është në ngjitje. Shpalos vlera nga më të ndryshmet. Repertori ka larmi që nga veprat e mira, e herë-herë hasim në vepra që u duhet tërhequr veshi. Te 'Senatori Fox' na pëlqeu interpretimi i aktorëve, që përcillin idenë për të zhvatur e shkatërruar. S'jam dakord me regjisorin për zgjedhjen e pjesës, sepse vërtet përkon me realitetin tonë deri diku, por është e konsumuar. Pjesë të mbushura me artifice e me zgjidhje si të 'Përrallat e 1001 netëve', me medaljone në qafë të njërit a tjetri. Këto janë mjete të konsumuara".

Fatmira Nikolli

ZAMIRA KITA:

Kemi teatër mesatar e mediokër, mjaft me furça

Kritika që Miho Gjini i bëri shfaqjes "Senatori FOX" të sjellë në Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrit, nuk u prit mirë nga trupa e teatrit të Vlorës. Si të mos mjaftonin kundërshtitë e trupës, në anën të tyre doli edhe Armando Bora e Albert Minga, që kërkuan nga kritiku i artit Miho Gjini, që dha mendimet e tij si kritik mbi përzgjedhjen e pjesës, interpretimin e aktorëve, gjetjet regjisoriale dhe vetë konceptin. Takimi i mbajtur që paralajmëruar të ishte një debat artistik mbi shfaqjet e festivalit, por shpesh artistët të pamësuar me kritika, nuk i mirëpresin ato. Në rastin kur kritikikat vijnë nga gazetarët, këta të fundit shpallen armiq, sepse sipas artistëve, nuk kanë as tagrin, as formimin që të bëjnë kritika, e kur këto vijnë nga kritika e mirëfilltë, ose kolegët e ndajnë veten para gjyqit.

DEBATI

Ishte Hervin Çuli, drejtori i Teatrit Kombëtar në ekzil te 'arTurbina' që u ul në panel i pari, duke ftuar kraht kritikun Miho Gjini dhe më pas trupën e Vlorës.

Profesor Miho në fjalën e tij, si fillim u ankua që shpesh nuk gjen për shfaqjet fletëpalosjet dhe të dhënat bazë, çka detyron sorollatje për të kuptuar kush luan kë, sepse ndodh të ngatërrohen. "Për Vlorën dua të them dy fjalë, përgjithësisht pozitive. Festivali është në ngjitje. Shpalos vlera nga më të ndryshmet. Repertori ka larmi që nga veprat e mira, e herë-herë hasim në vepra që u duhet tërhequr veshi. Te 'Senatori Fox' na pëlqeu interpretimi i aktorëve, që përcillin idenë për të zhvatur e shkatërruar. S'jam dakord me regjisorin për

SAIMIR GONGO

Si për t'i vënë kapakun refuzimit, fjalën e mori Saimir Gongo, autor e regjisor që në festival merr pjesë me "Pengu", për publikun i njohur me "Shtëpia pa dritare". "Nuk është puna jonë të gjykojmë kolegët. Ne do bëjmë punën tonë, të vëmë shfaqjet. Është spektatori, ai që e vlerëson një shfaqje nëse është e mirë a jo. Nuk jemi ne një komunitet gjyguesish. Jemi këtu për të dhënë përvojat tona, jo për të vënë trupat para togës. Jo për të bërë mësuesit a gjykatësit", tha ai.



Zamira Kita

diku, por është e konsumuar. Pjesë të mbushura me artifice e me zgjidhje si të përrallat e '1001 Netëve', me medaljone në qafë të njërit a tjetri. Këto janë mjete të konsumuara". Kaq tha Miho mbase duke u treguar shumë i butë me shfaqjen, pasi nëse e ke parë, e di mirë që edhe interpretimi çalon-te, e se aktorët shpesh ngatërrojnë/harronin tekstin. Por, kritikantat nuk pranohen.

Fjalën e mori regjisorin Armando Bora, i cili tha "prof.Miho ka fatin e madh që është dëshmitar i viteve '40-'50, por them që nuk mund të nisemi të paragjykojmë një regjisor për një trupë a për një pjesë. Ky tekst është vënë disa herë. S'mund ta penalizojmë pse ka zgjedhur këtë tekst. E kam nisur karrierën në Vlorë. Si rrallë trupë, ata kanë pasur fatin të punojnë me një regjisor që u ka dhënë atyre

një imazh. Sepse për fat të mirë a të keq, në teatrot ku ka shumë regjisorë, aktorët i përdorin si mjete regjisorë të ndryshëm". Debat i vazhdoi mes sallës ku ishte Bora e panelit ku ishte Miho Gjini, i cili mbase me gjasë u pendua se tha ç'mendonte, kur pa një grup t'i kthehej kundër vetëm pse guxoi të bënte punën e tij: kritikun e teatrit.

Si për t'i vënë kapakun refuzimit, fjalën e mori Saimir Gongo, autor e regjisor që në festival merr pjesë me "Pengu", për publikun i njohur me "Shtëpia pa dritare". "Nuk është puna jonë të gjykojmë kolegët. Ne do bëjmë punën tonë, të vëmë shfaqjet. Është spektatori, ai që e vlerëson një shfaqje nëse është e mirë a jo. Nuk jemi ne një komunitet gjyguesish. Jemi këtu për të dhënë përvojat tona, jo për të vënë trupat para togës. Jo për të bërë mësuesit a gjykatësit", tha ai. Në këtë rast fjalën e mori Çuli, i cili duke vënë në dukje dilemën për pjesën e debateve artistike, tha se kritika në vetvete këtë punë ka, të gjykojë shfaqjet. "Atëherë, çfarë është kritika në vetvete? Ne, gjithësesi nuk i shpëtojmë dot

zgjedhjen e pjesës, sepse vërtet përkon me realitetin tonë deri

JOSIF PAPAGJONI:

Aktorët duan të përkëdhelen, nuk durojnë kritika për rolet

Nga Josif Papagjoni

Në festivalin e teatrove shqiptarë që organizohet këto ditë në dy salla, 'ar-Turbina' dhe Akademinë e Arteve, pjesë e tij janë përpos të tjerave edhe idetë, mendimet, diskutimet që bëhen për shfaqjet në konkurrim, vlerat e paraqitura në përbërësit teatorrë: dramë, akt-rim, regji, skenografi, kostumografi, koreografi etj. Dikur kjo komponente që tejet e pranishme, energjike dhe me ndikese në përpunimin e opinionit dhe mendimit artistik, gjer dhe të estetikës së teatrit duke hedhur në tavolinë një mori çështjesh e temash që rriheshin shpesh me seriozitet e përkushtim në dialogun mes artistëve. Rasti e ka sjellë të jem pjesë e shumë tavolinave të rumbullakëta të diskutimit ose "tavolinat e kritikës". Nëse dikur, të themi para vitit 1990 këto bëheshin në mënyrë tejet serioze dhe kishin përsipër autoritetin e mendimit zyrtar, pra qenë, veç pjesës fisnike e të dobishme të rrahjes së mendimeve, edhe pjesë e kufizimit, kontrollit, ndrojtjes e shpesh frikës prej ndonjë ndëshkimi të mundshëm, gjegjësisht optikës së ngurtë të asaj kohe - pas vitit 1990 hapësira e mendimit kritik mbi shfaqjet erdhi përherë duke u zvogëluar e rrudhur sa u katandis kokoshi një thellë. Kritika nuk pranohej më në meset e artistëve, ajo u tkurr, u anashkalua, u shpërfill, humbi natyra e saj e institucionizuar si forum sipëran i mendimit dhe vlerësimit, gjersa u përjashtua. Ka një shumësi arsyeshe dhe rrethanash, por unë po e ndjej përherë e me shumë se mospërzanimi, konfliktualiteti dhe gjer cinizimi e grindjet mes kritikës dhe artistëve jo si individë, por tashmë si produkt artistik me përkatësi publike kanë ardhur duke u shtuar e thelluar. Artistët duan përherë një shportë me fjalë të mira, përkëdhelje e lazrime, si natyra të ndjeshme që janë, ndër-sa kritika përherë e më shumë i shmanget thënies së plotë, të singertë dhe pllenuesë të ideve e vlerësimeve të saj korrekte, me drojë se humb një mik, humb një



"Jam bezdisur aq fort, shpesh gjer në neveri, me mburrjet e aktorëve, lazdrimet e njëri-tjetrit kur janë pranë"

dium të mbytur nga mediokriteti intelektual dhe moral, nga rëndomtësia dhe shurret, sot më duket e largët ajo ditë. Njerëzit i bishtojnë shfaqjes hapazi të mendimeve. Madje, u bishtojnë forumeve ku mund të artikulohej një ide e plleshme, një mendim që hyn në punë. U pëlqejnë më shumë kafenetë, thasethemnjaja, nuk duan të gjykohen për punën e tyre që është, në fakt, publike dhe e gjykueshme gjerësisht, pjesë e shoqërisë. Pra, po e shoh se dhe këto tavolinat e kritikës po e humbasin rolin e tyre emancipues, po keqkuptohen dhe ç'është më e keqja, artistët vetë nuk kanë dëshirë t'i ndjekin diskutimet, u shmangen, nuk vijnë, u pëlqen më fort të pinë një kafe a gotë birre në barin ngjitur se sa të harxhojnë fjalë a të lodhin veshin në debate. Nuk kam parë as pedagogë a studentë të arteve, fare pak. Lëre po t'u thuash shfaq një mendim. Jo! Për hir të mohimit ndaj një forme tradicionale, shpesh dhe zyrtare dhe e veshur me autoritetin e shtetit dikur, them se nuk duhen braktisur forume të tilla estetike dhe intelektuale për të diskutuar për teatrin, gjenden dhe ardhmërinë e tij dhe konkretisht për shfaqjet e një festivali. Unë kam vënë re në mjaft festivale në Kosovë ku ka pasur një traditë të mirë të trashëguar, se këto tavolina vit pas viti kanë ardhur duke u rrudhur, por edhe ne jo pak festivale e veprimtari teatore që kam qenë në botë, ato kanë ndryshuar kah e trajtë. Shumë funksione mund t'i mbulononte p.sh. një gazetë e posaçme

që të botohej ditë e festivalit, a një buletin, a një portal me disa emra të njohur analistesh që shkruajnë dhe të tjerë që ftohen të japin mendime, duke shmangur doemos gjithë bërllokun që mund të ndërkallet nga mendjet dhe qëndrimet vulgare, cinike a perverse. Po ashtu, një tavolinë gazetareshe është e mirëpritur. Dhe, ndoshta, nga format me publike e promovese të mendimit kritik, janë rubrikat a bisadat e përditshme në televizione, me analizat e shfaqjeve, roleve, prurjeve, problemeve gjer dhe gjendjes së teatrit shqiptar sot, të cilat për fat të keq producentët dhe redaksitë e tyre janë fare pak të interesuar. Por, këtu duhen edhe ca para që të jenë pjesë e projektit, natyrisht. Po ashtu, një libër për festivalin, vlerat, çështjet, portrete, intervista etj., mund të ishte ideuar dhe realizuar. Nuk kushton asgjë në teknologjitë e sotme të botimit me një tirazh 100 a 200 kopje maksimale. Një film dokumentar, një... Ah, më duket se po më rreh si tepër fantazija, po kërkoj si shumë, po i iki të vërtetës që kemi nëpër këmbë... Nuk e di, por si zejtar i kësaj lamie, pra kritikës, e shoh se hapësira e saj zvogëlohet e zvogëlohet dhe nesër s'do t'i qaset kush kësaj udhe jo të lehtë, që kërkon njëherësh shumë dije, shumë guxim dhe shumë karakter... Por, si njeri që e dua teatrin dhe me një dozë jo të vogël optimizmi, ndoshta rrjedha e ujit shkollës së shtratit e duhur e nuk shkërmoqet rripërave të indiferencës, moskuptimit, shpërfilljes dhe ngulfatjes...

komunikim njerëzor, andaj dhe u shmanget sherreve të bezdisshme, gjer dhe delirive të ndokujt, boll ka hallet dhe streset e tij gdokush në një realitet që të refuzon ose të ironizon. Dhe ajo struket në qetësinë dhe paqen e vet; mjaftohet me shfaqjet e mira, shkruan për to, lavdëron, rëndom pa u futur telasheve etj., etj. Ose siç më pat thënë një mik im, sjell një maune me karamela e çokollata dhe ia shpërndan falas çdo trupe, shfaqjeje, artisti. Këtu nis pikërisht tjetërsimi fatal i kritikës,

hipokrizia, shtirja. E vërteta thuhet më së shpeshti pas shpine, në tavolina, rëndom edhe me cinizëm e mohime kategorike, dhe jo në sy. Unë jam bezdisur aq fort, shpesh gjer në neveri me mburrjet e aktorëve, lazdrimet e njëri-tjetrit kur janë pranë njëri-tjetrit, dhe porsa kthejnë shpinën flasin më të keqen për kolegun e tyre: ky është dështak, nuk gëlltitet dot, ka cofur, s'ka bërë kurrë etj., etj. E kur mund të vijë ajo kohë kur mendimin ta themi hapur, doemos me takt e qytetari? Në një me-

grykimit përderisa zgjedhim këtë profesion", tha Çuli. Po në një mendje me Miho Gjini dhe me tërë ata që duan të shohin veten para pasqyrës, për të mos thënë të tërë "jemi artistë të mrekullueshëm", ishte Zamira Kita, aktore e drejtore e Teatrit të Korçës. "Nuk mund të flasim ne për shfaqjet. Të jemi të singertë, është keq t'i bëjmë furça njëri-tjetrit. Ne kemi një teatër mesatar e mediokër. Kemi aktorë të mirë që e mbajmë skenën dhe aktorë që janë jashtë komplet. Le të më gjykojnë kolegët e le të më futin kokën në dhe, nëse unë nuk e bëj si duhet këtë punë. E pëlqen publiku? Po publiku merr atë që i japim ne. Se mund të dalë një të zhvishet dhe urra shkjojnë e shohin të tërë, por

kjo nuk do të thotë se pati vlera". Debatit për çështjen e cilësisë artistike dhe singëritetit për ta pranuar vlerën që ka secili vijoi edhe kur debati kaloi tanimë nga shfaqja e Vlorës tek ajo "Pirro" e Gjirokastërës.

Miho Gjini bashkë me kritikun Josif Papagjonin nga salla shtuan se askush s'bën dot kritikë, se askush s'e do kritikën. "Pavarësisht se ç'thote kritika, thotë unë kam bërë gjë të madhe", thonë të gjithë ata që vënë diçka në skenë. "Teatri ynë mendoj se duhet ta zgjedhë repertorin. Jo të vësh mballosa e shtesa me autorë shumë seriozë. Thashë që mjetet shprehëse e artificet janë të shumta", shtoi Gjini. Për "Pirron" ai kujtoi se dikur Hetem Haxhiademin e

quanin autor të ndaluar. "Nuk mund të përdorej në leksionet tona. Edhe vetë unë e quaja të mirë për lexim e jo për t'u vënë në skenë. Kjo vepër e Hetem Haxhiademit është e vështirë, i them bravo trupës që gjetën thelbin skenik. Kjo ishte eja për pushtet. Vepra që e dobet nga ana e strukturës e kompozicionit, por regjisori ka mundur të bëjë një unifikim. Në këtë vështrim e gjej të mirë - me gjysmë fjalë si trajtim të parë serioz të këtij autori. Mbretëresha e prince-sha ishin në tonalitet të besueshëm. Tonaliteti i ulët nuk kuptohej fare nga salla", tha Gjini.

Në këtë vazhde u hap edhe njëherë bisada për pjesët shqipe dhe vështirësinë që kanë për t'u

vënë në skenë. Josif Papagjoni vlerësoi të gjithë ata që rrezikojnë dhe kanë guxim të merren me pjesë shqipe, sepse sipas tij, ata marrin përsipër një risk të madh. "Të marrësh pjesë të huaja, të konfirmuar si pjesë në teatrot e huaj është më e lehtë, sepse ti e di tashmë që teksti është skenik. Pastaj plasim kopimet, se ka mijëra kasete a videokasete. Kemi parë ne që ndonjë pjesë e vënë në skenë. Kur e gjejmë në 'Youtube', kuptojmë që kanë kopjuar. Ku është puna e tyre? Kur ka pjesë të mira shqiptare, kam më shumë respekt".

Ndërrhyret nga salla për teatrin e Vlorës vijuan dhe Papagjoni u irritua disi. "Nuk më pëlqen që mblidhen 4 vlonjatë dhe e mbrojnë. Nuk ka më diktim si

dikur për mendimin. Ka diktimitë artistike", tha ai.

Për shumëçka nuk u ra dakord, për pjesë të tjera, u diskutua cilësia në tërësi pa përmendur emra, por rezultoi që disa teatrot nuk kanë sjellë shfaqje të mirë, sepse u është dëmtuar skenografia apo rekuizitat. Pas intervistave të Ndrizim Xhepës, që tha dy ditë më parë se vetëm 30% e shfaqjeve të festivalit vlejnë, fjala e Gjinit, Papagjonit e Kitës vunë një gurë të parë për cilësinë artistike. Sepse të gjithë dalin nga shfaqjet turivarur, kritikojnë kolegët e mbilëvdjnë veten, por në fakt, niveli është mbase edhe nën mesatar. Nëse nga 7 shfaqje, vetëm 2 kanë qenë në lartësinë e duhur, edukacioni është i qartë.

Opinion i Ditës

Po me Xhiselën, çfarë do bëhet?

Nga Rudina Xhunga

(vijon nga faqja 1)

...Mbase Balla vërtet nuk ka genë në komisarjat atë natë e nuk kishte pse të shkonte se mbrojtja që kishte babai i djalit të kallëzuar, ishte qenia deputet i partisë së Ballës, jo prezenca fizike në komisarjat e vetë atij. Kush e sugjeroi për deputet e dinte kë po zgjidhnin dhe pse e zgjodhën.

Unë nuk shkova në Krujë të pyes për deputetin Rraja, i lexova vetëm biografinë në FB dhe jam e qartë që një njeri që bën të mesmen në "80 dhe të lartën në 2003, nuk është tipi deputetit që ka merak do marrë Nobelën Kadare, apo jo në tetor.

Ndërsa PD të mos mbajë hall për oficerin e policisë, që në vend të vetingut zgjodhi azilin, se sa më shume zhurmë të behet, aq më lehtë do e marrë ai.

Do me vajzën çfarë do bëhet? Vajza është e pambrojtura në këtë dramë.

Është ajo që u dhunua, u gjet pre e lehtë, se nuk ka babanë, është vajzë fshati, jeton vetëm me një motër e nënën, u rrëmbye, shpëtoi



pa e vrarë, se tërhoqi kallëzimin dhe pastaj u mor serish me dhunë të mohohte kallëzimin.

Se është e thjeshtë të dhunosh një të pambrojtur e pastaj ta bësh këtë edhe publikisht.

Por çështja është kur i hap derën të fortëve, kur bëhesh me të fortin, kundër të dobët, nesër e ke radhën ti. Ngjarja nuk ndodhi në Siri, ndodhi në Krujë. Dhe çfarë ndodh kaq afër, të vjen nesër te

dera.

Do dalë nesër një i fortë edhe për ty, diku po të pret, se çfarë bën, gjen.

E gjen dhe atëherë pyete veten sa të duash, si u bë ky vend

kështu? U bë, se nuk fole ti. U bë se kujtoje që ishin punë kurvash e kriminelësh, punë pozite dhe opozite.

Jo, ishin dhe janë punë drejtësie dhe padrejtësie. Punë shteti dhe antishteti, punë të fortësh që jua japim ne fuqinë ne, me heshtjen tonë.

Pastaj ata kujtojnë se janë edhe të mençur.

Epo kur të vijnë deri tek ti, mos prit të vijë kush në ndihmë.

Se kështu bëre edhe ti kur një vajzë e re nga fshati, u rrëmbye, dhunua publikisht dhe nuk e lanë të vuajë as në heshtje se duhej të tregonte se nuk qe Balla në komisarjat.

Ore njerëz, keni vajza ju, gra, motra, nena? Vërtet besoni se nuk e kanë radhën ato, nëse kjo klimë kthehet në normalitet? Unë sot jam me Xhiselën, që as emrin nuk ia mësova mirë, se ia thane të gjithë ndryshe, ngaqë më e pakta ju interesonte emri saj.

Epo mua ajo me intereson, vajza e pambrojtur, për të vetmen që nuk do t'ia dijë kush, në këtë histori të ndyrë dhe të ligë.

Dritare.net

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinioni *i* Ditës

Rasti Xhisela dhe organizata e strukturuar e Rilindjes

Nga Armand Shkullaku

(vijon nga faqja 1)

... rrjeta e Rilindjes nuk i kap peshqit që notojnë në ujërat e saj. Rasti i Xhisela Malokut përbën një rekord të ri në listën e turpit të kësaj mazhorance që, në pesë vite me radhë, shqetësim kryesor ka pasur mbulimin e krimeve dhe aferave korruptive të organizatës së Rilindjes.

Historia gati njëvjeçare e dhunimit të një vajze të re, që jeton vetëm me nënën dhe motrën e saj, nga djali i një deputeti të Rilindjes nxjerr në dritë angazhimin e strukturave shtetërore për të mbuluar krimin dhe për t'i mbyllur gojën viktimës. Vajza, pa asnjë mbrojtje tjetër përveç asaj që mendonte se mund të gjente tek shteti, është sorollatur nga një komisar i atë tjetrin vetëm për t'u dhënë kohë dhunuesve të saj, që nëpërmjet presionit fizik ta detyronin të tërhiqte denoncimin.

Prokuroria e ka pyetur vetëm një herë, një herë të vetme, ndonëse në dëshminë e saj tregojë me detaje sa herë ishte dhunuar, si e kishin mbyllur në një dhomë hoteli, e kishin goditur me pistoletë në kokë, e kishin djegur me cigare dhe e kishin kërcënuar të mos hapte gojën. Nuk janë pyetur edhe personat e tjerë, që sipas dëshmisë, ishin në dijeni për torturën e vazhdueshme ndaj Xhiselës. Dhe nuk është lëshuar asnjë urdhër ndalimi për djalin e deputetit të Rilindjes, që akuzohet direkt nga vajza si autor i dhunës fizike mbi të.

A mund të kuptohet nga një njeri normal se si një person i ngarkuar me të tilla akuzat nuk arrestohet? A ka shpjegim logjik kur, po për të njëjtin individ, ka



edhe rekorde të mëparshme kriminale, për të cilat madje është shpallur edhe në kërkim?

Veglat e propagandës mediatike të Rilindjes, që me kohë e kanë kapërcyer yberin e ndërgjegjes profesionale, u kapën plot entuziazëm tek fakti se vajza e kishte tërhequr denoncimin dhe se ajo tashmë me djalin e deputetit rilindas ishin dy shokë të mirë dhe... me kaq çështja quhet e mbyllur. A mundet dikush, aq më tepër një gazetar, të mos e ngrejë të paktën dyshimin se përse një vajzë 24-vjeçare, me babain e vrasë kur ishte vetëm 4 vjeç, që i duhet të dalë e vetme në një zonë që as policia nuk e kontrollon dot, e tërhiqte denoncimin? A mbërrin deri këtu çnjerezëzoria sa të mos ndjesh asgjë për viktimën, vetëm nga shërbimi për të nxjerrë të pafajshëm

dhunuesin? Dhe a ekziston rast më hipokrit kur shfaq ndjeshmërinë se si Xhisela është lënduar nga një status në "Facebook" i Sali Berishës, por refuzon të shpreh shenjat mbi trupin e saj vetëm se ato mund të kenë për autor një pinjoll të organizatës së Rilindjes? "Ta mbrojmë Xhiselën nga ata që duan të bëjnë politikë me të, nga dhunuesit pak rëndësi ka. Denoncimi u tërhoq, krimi nuk ekziston", dhe me kaq propagandistët e Rilindjes e kanë kryer detyrën e tyre.

Po a ka burrë, jo më një vajzë e re dhe e vetme, që në kushte të tilla nuk do ta tërhiqte denoncimin? Gati çdo ditë është e ngarkuar nga kronika e banditëve që veprojnë hapur dhe nuk u hyn gjemb në këmbë sepse i shërbejnë organizatës. Kërcënohen njerëz, u rrëmbe-

hen pronat, qëllohet me armë shtëpia e gazetares, ndodhin vrasje dhe nuk zbulohen autorët, kriminelët hapin biznese e madje fitojnë edhe tendera publike, e të gjitha këto përpara syve të njerëzve që ndihen të pafuqishëm.

Dhe Xhisela, banorja e zonës më të zezë të krimit në Shqipëri, do t'i shkonte e vetme përballjes deri në fund me njerëz të armatosur me armë dhe pushtet politik? Në një vend me sadopak ndërgjegje qytetare, përveç zbardhjes deri në fund të ngjarjes kriminale, detyrim i parë do të ishte zbulimi se përse 24-vjeçarja e tërhiqte denoncimin.

Por ky hetim këtu tek ne do të përfundonte në ujërat ku peshkojnë sot gjuetarët e Rilindjes. Prandaj e gjithë zallamahia e propagandës bëhet për t'i turbulluar ato. Në ato ujëra do të shpinin edhe hetimet për skandalin e Sharës, për deputetët që komunikojnë me banditët, për makinën e Saimir Tahirit, për shokët e Taulantit që dënohen për trafik ndërkombëtar droge dhe fitojnë tendera publike, për vëllain e Fatmir Xhafajt, për bandat në Elbasan, Durrës apo Vlorë. Por në vend të hetimeve, ne kemi marrë porcionin e bollshëm të propagandës, që e përhapin me të njëjtin entuziazëm si ata që e gatujnë, ashtu edhe ata që e shërbejnë.

Nuk ka rëndësi nëse Taulant Balla ka qenë ose jo fizikisht në komisaratin e Krujës për të mbyllur një aferë që prekte organizatën e tij. Mekanizmi është kurdisur të funksionojë njësoj edhe kur je për peshkim në ujërat e Ohrit, apo për gjueti më të madhe në ato të Adriatikut. Kodi i këtij mekanizmi është i qartë: pjesëtarët e organizatës janë të paprekshëm. Rasti i Xhiselës shkon me të shumtit.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të ndiheni plot energji pozitive, çfarë do t'ju sjellë një atmosferë shumë të këndshme. Do të kaloni një ditë pasionante me partnerin/partneren tuaj. Megjithatë, bëni kujdes të mos tregoheni shumë kërkuës ndaj tij/saj, pasi mund të shkaktoni probleme.

DEMI

Ardhja e një vizitori surprizë do t'ju sjellë ndjenja të ndryshme. Nga njëra anë, mund të gëzoheni pasi do të rrisni marrëdhënien me të, por nga ana tjetër, duke qenë se nuk prisnit dikë, mund t'ju shkaktojë shumë punë.

BINJAKET

Sot do të ndiheni të pakënaqur nga ana financiare dhe për këtë arsye nuk do të keni mundësi të realizoni planet tuaja. Përpuni t'i zgjidhni vetë problemet, pa kërkuar ndihmën e të tjerëve.

GAFORJA

Dikush pranë jush ju ka gënjyer së fundmi dhe sot do ta zbuloni. Kjo do t'ju bëjë të dyshoni ndaj çdo fjale që do ju thonë të tjerët. Përpuni ta kaloni këtë situatë dhe të mendoni për diçka të këndshme.

LUANI

Do të kaloni një ditë shumë të bukur. Do t'ju duket sikur po përjetoni një përallë. Partner/partnerja juaj do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush. Ka gjasë t'ju anulohet një plan, por mos u shqetësoni, sepse do të ketë aktivitete të tjera gjatë ditës.

VIRGJERESHA

Sot do të keni dëshirë të ndryshoni arredimin e shtëpisë. Sa i përket jetës personale, bëni mirë të mos eksperimentoni. Mos filsi për vendimet që keni marrë, pasi kështu mund të shmangni skandalet apo xhelozinë rreth jush.

PESHORJA

Do të ndiheni të lodhur dhe nuk do të keni dëshirë të përfshihen nëpër aktivitete të ndryshme. Nëse përpuni të shmangni përgjegjësitë që u takojnë, rrezikoni të shkatërroni reputacionin tuaj. Do të ndiheni mirë sapo të vazhdoni projektin që keni lënë përgjysmë.

AKREPI

Ka gjasë që sot të ndiheni të irrituar dhe të acuruar. Kontrolloni veten, pasi mund të largoni nga jeta juaj një person shumë të rëndësishëm. Sot mund të zhvilloni disa takime me vlerë, të cilat mund t'ju ndryshojnë të ardhmen.

SHIGJETARI

Sot mund të tregoheni pak egoist, përpuni të mendoni më gjerë. Njerëzit rreth jush do t'ju vlerësojnë nëse përpuni të bashkëpunoni me ta. Mos qëndroni i/e vetëm, por shoqërohuni edhe me të tjerët në punë.

BRICJAPI

Sot do të ndiheni optimist. Ndenja e lumturisë do t'ju shoqërojë gjatë gjithë ditës. Do të keni mundësi të argëtoheni me miqtë, por ndërkohë ka gjasë të planifikoni edhe një udhëtim me familjen.

UJORI

Do t'i përkushtoheni maksimalisht vetes dhe do të shpenzoni mjaftueshëm kohë për t'u relaksuar. Kjo do të ndodhë për shkak të anulimit të një eventi të parashikuar për ditën e sotme. Nëse ju ka shqetësuar diçka gjatë këtyre ditëve, diskutoni me partnerin/partneren tuaj.

PESHQIT

Ka gjasë të përplaseni me dikë pranë jush, për shkak të natyrës suaj agresive sot. Mbani veten nën kontroll, pasi mund të kryeni një veprim, për të cilin do të pendoheni shumë shpejt. Gjithashtu, mund të jeni në qendër të kritikave prej shqëljes suaj.

PËRCAKTOHET EUROPIANI



UEFA ka bërë zyrtare dje emrin e vendit organizator të Euro 2024, duke zgjedhur mes dy kandidatave që ishin vënë përballë Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s për votim. Gjermania dhe Turqia ishin dy vendet e vetme ap-

UEFA zgjedh Gjermaninë, zhgënjehet Turqia

likuese për të zhvilluar këtë avitet dhe UEFA vendosi që t'i besonte Gjermanisë organizimin e turneut që zhvillohet në vitin 2024. Turqia kishte aplikuar edhe disa vite më parë për organizimin e

Euro 2016, por në fund, kandidatura e cila asokohe dukej shumë e fortë, u mund nga Franca. Këtë radhë, Turqia sfidonte një tjetër emër të madh si Gjermania, e cila ka disa nga stadiumet më të mira

të kontinentit. Duket se kjo, si dhe infrastruktura e niveleve më të larta e testuar që më Botërorin 2006, bindi UEFA-n që të kthente Europianin në Gjermani për herë të dytë, pasi më parë aktiviteti ishte zhvilluar në Gjermaninë Perëndimore në vitin 1988.

Trajneri bardheblu shprehet se derbi i kryeqytetit për të është ndeshja e radhës

Ze Maria: E thyejmë Partizanin, Muka? Deklarata joprofesioniste

Braziliani kërkon t'i japë fund dominimit të kuq



Jeton Selimi

Tirana ka shumë kohë që nuk nje sukses in në derbi dhe tashmë sfida me Partizanin është kthyer në një duel prestigji më shumë se të tjerat. Por për trajnerin Ze Maria, ndeshja ka më shumë rëndësi për tre pikët sesa për sfidën që përmban brenda vetes. "Ndeshja e nesërme (sotme) është më e rëndësishme për ju, për ne është një ndeshje që vlen tre pikë. E kuptoj çfarë ndodh rreth e rrotull, por kjo është ndeshja e radhës nga e cila synojmë maksimumin", tha ai në konferencën e sotme për shtyp. "E di që kemi 13 ndeshje rresht pa fitore, jam këtu për të thyer këtë seri. Pastaj rezultatin do t'ia lëmë fushës. Frikë? Nuk ka frikë, respekt për kundërshtarin që një ekip i madh si ne. Nuk premtoj fitoren, por që do të japim maksimumin. Në mentalitetin tonë është të luajmë për fitore në çdo ndeshje. Titullin apo derbin? Të dyja. Unë dua titullin se tifozët janë të lumtur po fitove kampionatin, derbi të mërzit për



një ditë", tha Ze Maria. Ndërkohë, trajneri u ndal edhe te fjalët e Devi Mukës, i cili kishte thënë se po të ishte në vend të Karabecit, do të largohet nga Tirana.

"Ai është opinion i tij, Erando është një profesionist që e kupton situatën. Ai kishte mundësinë e tij, tani e kanë të tjerë për të luajtur. Nuk më intereson ajo

që mendojnë të tjerët, lojtarët nuk duhet të mendojnë se nëse nuk luajnë duhet të ikin. Mendoj se nuk është sjellje profesioniste", tha Ze Maria.

MBROJTËSI KUQEZI

Mavraj bind grekët në debutimin e tij

Mërgim Mavraj ka debutuar dje me fanellën e Aris në derbin e ndezur kundër PAOK, i cili u mbyll me shifrat 1-1. Për futbollistin shqiptar, kjo ishte ndeshja e parë në klub që në muajin shkurt, kur zbriti në fushë për herë të fundit me fanellën e Hamburgut, ndërsa gjatë kësaj periudhe kishte luajtur vetëm me fanellën e përfaqësueses shqiptare. Nuk ishte një ndeshje perfekte, por Mavraj ka marrë vlerësime pozitive për paraqitjen e tij. "Përshlytja e parë është pozitive. Cilësia e 32-vjeçarit nuk vihet në diskutim ndaj trajneri Pako Erreza i besoi një fanellë në një ndeshje kaq të rëndësishme", shkruan portali grek "Sportime". "E dukshme ishte se Mavraj është mbrapa pjesës tjetër së skuadrës sa i përket anës fizike, gjë që është e kuptueshme sepse nuk ka bërë fazë përgatitore. Megjithatë, vendimet e tij gjatë ndeshjes ishin korrekte, nuk bëri veprime të panevojshme dhe i duhen dhënë merita se nuk ndërmori shumë iniciativën, meqë e di se nuk është ende gati. Por ai ishte vendimtar në bllokimin e Kareli dhe Prijovic. Gjithsesi, ai tregoi se do të bëjë diferencën në qendër të mbrojtjes dhe mund të bëhet pika e referimit të lojës së Arisit në prapavijë", shkruante portali i njohur grek për mbrojtësin shqiptar.

VLERËSIMI

Portieri legjendar italian, Khanluixhi Bufon beson se shoku i skuadrës së tij të PSG-ja, Marko Verrati është "i vetmi talent i vërtetë i futbollit italian". "Është shumë e qartë", tha Bufon për "La Gazzetta dello Sport". "Marko është një lojtar i pabesueshëm, në këtë moment ai është talenti i vetëm i vërtetë i futbollit italian në aspektin e mënyrës se si ai luan ndeshjen, cilësinë e kontaktit të tij me topin dhe mënyrën se si ai e sheh lojën. Kur luan me lojtarët nor-

Bufon: Verrati, italiani më i mirë i momentit



mal, ai mund të luftojë, sepse ata nuk e kuptojnë atë, ndonjëherë ata që janë shumë të mirë përpiqen që të kuptohen nga të tjerët. Këtu, Marko është me fat që luan përkrah lojtarëve

të mëdhenj, të cilët menjëherë janë në gjendje të kuptojnë se ku do të shkojë topi dhe ku e duan, kështu që ju shihni se të gjitha lëvizjet e tij janë lehtësuar", u shpreh Bufon.

Ish-presidenti kurorëzon Napolin


Morati: Interi nuk është më anti-Juventusi



së shkua: "Modrić tek Interi? Nuk di asgjë për atë që ka ndodhur dhe as për perspektivat". Ai u pyet, gjithashtu, nëse Interi është Anti-Juve në Serie A. "Interi nuk është më Anti-Juve, sepse tani është Napoli".

Ish-presidenti i Interit, Massimo Morati ka thënë se nuk e di pse zikaltrit nuk mund të nënshkruanin me Luka Modrić këtë verë dhe nuk e kupton se çfarë ndodhi saktësisht në sagën e transferimit. Modrić u lidh shumë me një lëvizje te Interi këtë verë dhe ishte i etur për të lënë Real Madridin, gjithashtu, por "Los Blancos" bindën kroatin të qëndronte në klub. Morati është pyetur rreth sagës së transferimit dhe ka thënë mendimin e tij për "çështjen" Modrić. Ai tha se nuk e di pse kroatin nuk u bashkua me Interin gjatë merkatos

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Niven që që aktor.
- Little... kryeqyteti i Arkansas.
- Janë tek në lakër.
- Nuk ka akoma një bebe.
- Kufizojnë katete.
- Penn aktor.
- Hector që shkroi Pa familje.
- Thahen me bonifikime.
- Mbyllin takimin.
- Nëdërmjarje Industriale Mat.
- Mbyllen me epilog.
- Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
- Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
- Njëlljo për latinë.
- Eshhtë vendi si Katar.
- Pupi regjisor.
- Janë strëhat e çobanëve.
- Eshhtë centrali si Chernobyl.
- Fillojnë një argument.
- Të parat në stadium

- Mund të sjellin shi.
- Kështu fillon Odisea.
- Një mund të jetë emërore.
- Thirrej edhe kështu Persefoni.
- Ai dhe ajo.
- E ka lënë atë që s'ka fuqi
- Para es Salaam.
- Ylli i Londrës.
- Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

- Hyskja aktor.
- Kush e thotë lutet.
- Një tis mjegulle.
- Maiden që këndojnë.
- Gjysmë rekord.
- Antonio skulptor i famshëm.
- David regjisor.
- Janë brinjë në skuadër.
- Ruan në kufij.
- Mban mikrofonin.
- Janë edhe ato të fytyrës.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Demek pa kufij.
- Mund të jetë atomike.
- Qyteti i përjetshëm.
- Kitara e Ravi Shankar.
- Janë katrore në sipërfaqe.
- Një fjalë si gjoja.
- Pak daktilografi
- Eshhtë si divan.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Bernhardt që që aktore.
- Eshhtë infeksion në veshë.
- Një mund të jetë unik
- Gjysma e sasisë.
- Pak marramendëse.
- Eshhtë dhomë.
- Fillojnë takimin.
- Në fund majtas.
- Të fundit në manastir.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- E bardhë ajo Moby Dick.
- Fillojnë amplifikimin.
- Eshhtë vit që parashikohet.
- Mbyllin pamjen.
- U printe jeniçerëve.
- Thurman aktore.
- Një reaksion në provëz.
- Një sport me brez të zi.
- Në fund të fundit.
- Janë në gjyq.
- I është hequr të dënuarit.
- Eshhtë shahu i fundit
- Janë fletë trëndafil.
- Kufizojnë një metër.
- Tregojnë pallate në miniaturë.
- Një fjalë pa shkak.
- Janë përlogaritje.
- Mbyllin një dritare.
- Të parat në muzg.
- Me të nxjerrin një letër.

VERTIKALI


- Ishte titulli i Hiro Hitos.
- Ekberg aktore.
- Eshhtë skuadra.
- Dy asa.
- Binjaket në klasa.
- Qe duhet sajdisur.
- Nuk i bihet me kokë.
- Sharif aktor.
- Janë organet e taksave.
- Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
- Vihen për të mbyllur.
- Janë vegla.
- Eshhtë medalja e të parit.
- I dhimbset frikacakurit.
- Mund të jetë mbi xhiro.
- Eshhtë llathar.
- Janë inate të akumuluar
- Eshhtë vëlla i gruas.
- Një tip për të këcyer.
- Eshhtë Edoard piktor.
- Lumë në Francë.
- Janë djemtë e... nënës.
- Lindi Akilin.
- Kodi i celularit.
- Mbledh basket separatistë
- Një është edhe Egjeu.
- Fillojnë një metodë.
- Dy anët e një neni.
- Fillojnë ofensivën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7	4	1	3						
	8		3	5		7	1		
						5			
			5						
	3	9	6				4		
7	9	1	8						
	2					6	8		
		6			2	4			
			7	5					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	8	5	7	9	3	2	1	
1	3	9	2	8	4	7	5	6	
2	5	7	1	3	6	8	4	9	
5	7	2	3	9	8	6	1	4	
3	1	6	4	5	2	9	7	8	
8	9	4	6	1	7	2	3	5	
7	2	1	8	6	5	4	9	3	
9	8	5	7	4	3	1	6	2	
6	4	3	9	2	1	5	8	7	

Argëtim filozofik

- Unë do t'ju thërrisja në një duel shpirtëror, por e shoh se jeni i paarmatosur - William Shakespeare
- Ishin të bukur sytë e tu, por nuk dinin se ku të shikoni.
- Kur të bërtisni përpara, duhet ta bëni të qartë për në ç'drejtim - Anton Chekhov
- Njëzërit nuk interesohen nëse është dimër apo verë kur ata janë të lumtur - Anton Chekhov

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

2	11	2	11	1	7	1	13	4	1	3	S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T
4	6	2	15	1	3	6			1	3	A	R	M	I	K	S	T	O	L	I	T	E
5	2	7	8		7	2	11	1	8	1	L	I	O	R	O	M	I	N	A	T		
	17	1	13	6	12	9	5	1		3	L	O	C	A	B	A	R	E	T		L	A
17											A	B	A	T	E	R	I	T	E		A	R
5	2	8	9	7	1	12	1	3		11	T	R	I	M	E	R	I	T	E		A	N
2	13	3	1	13	2	2	3	2		2	A	R	T	U	R	O	U	I		M	A	T
13	2	13	3	1	16	3	8	2	5	2	A	R	S	E	N	E	A		I			
7	13	1			6	6	8	6	5	1	A	D	A	T	M	E	T	R	I		C	
	6	15	2	13	2	7		2	1	7	P	A	K	T	P	I	R	A	T	E	R	I
15	B	A	S	R	I	2	8	1	3	13	K	U	A	L	I	T	E	T	I		E	P
1		15	2	16	3	6		2	17	2	L	E	C	E	P	I		N	A	T	A	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FERMANI T J N A
 AKSI L O V A L E
 RO NE P F R E N A T I
 A H I P O K R I T E T D
 D E M O S T E R N I T K E
 D I K A S T E R E T N O R
 A M A L I A T Z E N E A
 D E L E R A T E O E
 A R I E P I T E T E T I
 I O M A I D M A D H I
 S R I R E I E L I R E N
 T E R R O R I A R E N A T

FJALËKRYQI (2)

L U I S S P A M A L I A
 A L E K T R O B E R T A
 P E R I O D I K A R E N A
 E I N A L J A A R E N A
 R E P A R T E T N S I A
 T E R E K S I P N
 P A R E T T R U K E T I
 A R I T F R E A L K U P A
 S F I T I M E T
 T A N D E M N E R E U R
 A H O T E L E T T R A U
 J U K A T E R A R M

Thënie të mençura

- Nëse i zbuloni fshehtësinë tuaj erës, mos e fajtoni pastaj kur t'ua thotë pemëve - Kahlil Gibran
- Nëse shpirti juaj është një vulkan, si prisni që lulet të çelin atje? - Kahlil Gibran
- Kur të dalësh dhe të fillosh të ecësh, do të duket dhe rruga - Rumi
- Shfaqja e gjërave ndryshon sipas emocioneve tona - Kahlil Gibran

